



Monografi

2001-2021

Monografi

2001-2021



ShKÇAK - Dekada e dytë 2001 – 2021



Është një nder dhe privilegj për mua të prezantoj të arriturat dhe kontributin e paraardhësve të mi, të zyrës tonë ekzekutive, të anëtarëve tanë dhe të palëve me interes kombëtar e ndërkombëtar.


Të gjithë së bashku ndërtuam këtë organizatë profesionale me qëllim të zbatimit dhe promovimit të standardeve ndërkombëtare dhe praktikave më të mira për profesionin e kontabilitetit dhe auditimit, si dhe asistimit në zhvillimin ekonomik në të mirë të interesit publik.

Përvoja jonë 20 vjeçare ofron një bazë më të qëndrueshme në përballjen e profesionit dhe organizatës tonë profesionale me sfidat e së ardhmes dhe ekzistencës në vijimësi.

Duke shënuar përvjetorin tonë të 20-të, dua të shfrytëzoj këtë mundësi për t'ju falënderuar të gjithëve për të arriturat tona deri më sot.

Ky është rrugëtimi ynë i përbashkët. Rrugëtim i cili na solli krijimin dhe zhvillimin e një organizate profesionale lidere, e cila është e lidhur ngushtë me krijimin dhe zhvillimin e ekonomisë dhe të shtetit tonë.

Shpresa Mustafa
Kryetare e Bordit
2020-2022



20 vite me SCAAK!



Rruga drejt zhvillimit të ShKÇAK për mua ishte e qartë – Të vë Kosovën në hartë globale përmes ngritjes dhe forcimit të profesionit që kontribuon në zhvillimin ekonomik të vendit tonë ende në fillim të rimëkëmbjes nga gjendja e pasluftës. Duke ardhë me përvojë të punës nga Misioni Ndërkombëtar i Kombeve të Bashkuara (UN) dhe OJQ të shumta, unë i vura disa kushte vetvetes: nëse ShKÇAK nuk bëhet e rëndësishme për zhvillimin ekonomik të vendit dhe e njohur ndërkombëtarisht, ajo bëhet thjeshtë një OJQ që ka filluar e financuar nga donatorët dhe ka përfunduar punën e saj me mbylljen e projektit.

Me anëtarët themelues dhe kolegët e mi Lendita Shahini, Lulzim Zeka dhe Afërdita Pustina vendosëm hapat e parë se kush jemi, pse ekzistojmë, çfarë synojmë të arrijmë dhe si planifikojmë ta arrijmë atë.

Misioni ynë i palëkundshëm ishte përkushtimi jonë ndaj vlerave profesionale, standardeve, etikës dhe shërbimit të interesit publik dhe jo interesave personale të një ose më shumë kontabilistëve, auditorëve apo industrisë në përgjithësi.

Për mua ishte një kontratë e re në mes të anëtarëve dhe çdo pale me interes në ekonominë e Kosovës, gjithashtu edhe komunitetit të donatorëve.

Fillimi i trajnimeve ishte sfida më vete. Ne si Shoqatë bëmë administrimin e trajnimeve dhe provimeve ndërsa projekti i financuar nga USAID Përkrahja e Biznesit Kosovar (PBK/KBS) zhvilloi materialet, provimet dhe ligjërimin. Në të njëjtën kohë zhvillohej baza ligjore për profesionin e kontabilitetit, auditimit dhe shoqatave profesionale. Sfida më e madhe ishte ndërrimi i të menduarit nga sistemi i mëparshëm ish-Jugosllav. Nuk ishte e lehtë të hysh në agjendat e politik-bërësve pasi që Shoqata zhvillohej në kohën kur Kosova ende ishte në kohën e emergjencës së pasluftës. Por, përkushtimi i të gjithë themeluesve dhe stafit të zyrës bëri që të kthejmë vëmendjen e politik-bërësve dhe donatorëve kah profesioni ynë.

Fokusi im ishte zhvendosur për të lobuar tek donatorët që ofrojnë projekte të mëdha për të na mundësuar të ndërmarrim hapa më të shpejtë dhe të rëndësishëm në zhvillimin e ShKÇAK.

Gjatë rrugës kemi tërhequr mbështetje direkte dhe indirekte nga një sërë donatorësh. Ne jemi mirënjohës për mbështetjen e dhënë nga Banka Botërore, USAID-i, BE-ja dhe partnerët e ndryshëm si Carana Corporation, Royal NIVRA etj. Segmente të caktuara të projekteve të ndryshme na e kanë mundësuar krijimin e materialeve të trajnimit, të zhvillojmë Shoqatën tonë, të ndihmojmë në zhvillimin e kornizës ligjore dhe anëtarësimin në FNK, EFAA, FCM dhe njohjen e kualifikimeve të ShKÇAK në nivel global.

Unë i kisha vënë vetes edhe një mision tjetër, të rris numrin e anëtareve gra në Shoqatë.

Në të gjitha takimet e mija me anëtarë dhe profesionistë të kësaj fushe, jo vetëm në Kosovë, por edhe në takimet e mija ndërkombëtare, zakonisht përfaqësuesit e profesionit ishin meshkuj. Isha e përkushtuar të lloboj dhe të punoj në tërheqjen e grave në profesion. Fillova nga zyra ekzekutive duke punësuar më shumë gra për pozita të rëndësishme: Lendita – udhëheqëse e administratës dhe burimeve njerëzore, Flutra - udhëheqëse në financa, Edona – udhëheqëse në departament të edukimit, Burbuqja – udhëheqëse në departamentin e shërbimit për anëtarë. Ndër vite, personeli ka pësuar ndryshime, por prapë në zyrën ekzekutive të Shoqatës, numri i të punësuarve dominon me përqindje gra. Në Bordin e Shoqatës filluan të nominohen gratë, në komisione gjithashtu. Edhe në këtë moment kur po shkruaj, kryetare e Bordit të ShKÇAK-së është një grua.

Shembulli nga Zyra ekzekutive ndikoi edhe tek anëtarësia dhe tash me mburrje e them se puna ime u shpërblye, pasi që sot 51% e anëtarëve në Shoqatë janë gra.


Gjithashtu është punuar shumë me gjeneratat e reja që ata të kuptojnë se profesioni i kontabilitetit dhe auditimit është shumë më atraktiv sesa që ishte perceptimi i publikut. Tanimë gjeneratat e reja të anëtarëve tanë mbajnë shumë nga pozitat më të larta në industri dhe tregti dhe në të gjithë sektorët tjerë të ekonomisë dhe janë profesionistë jashtëzakonisht të respektuar.

Është vështirë të përshkruaj të gjitha punët që janë bërë deri më sot, por ajo që më duhet të them është se kam pasur kënaqësinë dhe fatin të kem një staf të përkushtuar afër vetes në tërë këtë rrugëtim, pa të cilët e tërë kjo arritje nuk do të ishte e mundur. E vlerësoj lartë punën dhe përkushtimin e tyre, e posaçërisht etikën e lartë profesionale që ata e kanë.

ShKÇAK nuk do të ishte këtu sot pa ju të gjithë.

Ju falënderoj për këto 20 vite punë dhe ju uroj të gjithë anëtarëve, Bordit, komisioneve dhe zyrës ekzekutive 20 vjet SCAAK!

Ardiana Bunjaku
Drejtoreshë Ekzekutive



MESAZHET NGA KRYETARËT E FEDERATAVE NDËRKOMBËTARE



“Profesioni i kontabilitetit në Kosovë nuk humbi kohë në identifikimin e nevojës së profesionistëve kontabilistë dhe auditorë për mbështetjen e funksionimit efektiv të bizneseve, duke iu bashkuar profesionistëve botëror për të përforcuar profesionalizmin e kontabilistëve dhe auditorëve në vend. Vizioni që ka treguar ShKÇAK është i jashtëzakonshëm.

Profesioni ynë ka një të ardhme të ndritur dhe falënderoj secilin anëtar të ShKÇAK-së, që janë apo ishin, pjesë e rëndësishme e saj.”

Alan Jonson

President - Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve (IFAC)

"Ndër vite, ShKÇAK ka kontribuar dukshëm në objektivat thelbësore të EFAA-s duke promovuar rolin e profesionit të kontabilitetit dhe auditimit, si këshilltar i besuar i NVM-ve dhe në shërbim të interesit publik dhe zhvillimit ekonomik. ShKÇAK, në veçanti, promovon standardet më të larta të etikës, edukimit dhe përsosmërinë profesionale. Reformat në praktikën profesionale janë më se të rëndësishme.

EFAA për NVM-të është zëri i PVM-ve në Evropë. Së bashku me ShKÇAK, ne punojmë për tu siguruar se PVM-të janë duke ofruar shërbime të cilësisë së lartë; shërbimet që ofrohen nga PVM-të janë qenësore për mirëqenien dhe rimëkëmbjen e NVM-ve. Ne vlerësojmë shumë mbështetjen e vazhdueshme nga SHKÇAK."

Salvador Marin,
President - Federata Evropiane e Kontabilistëve dhe Auditorëve për NVM (EFAA)



"Gjatë mandatit tim si President i FCM-së kam pasur nderin dhe privilegjin të bashkëpunoj me ShKÇAK në shumë raste dhe kam arritur të vlerësoj shumë rëndësinë e saj për mjedisin financiar në Kosovë.

Po aq e rëndësishme, unë kam arritur të njoh ShKÇAK si një partner të besueshëm dhe anëtare të rëndësishme të FCM-së, puna e së cilës ka ndihmuar në përforcimin e lidhjeve të institucioneve anëtare të FCM-së duke synuar që të krijohen lidhje sa më të ngushta ndërmjet pjesëmarrësve të rëndësishëm të komunitetit të kontabilistëve dhe auditorëve në Mesdhe.

Si përfundim, më lejoni t'ju uroj një të ardhme të suksesshme për ShKÇAK dhe profesionin në Kosovë."

Panagiotis Alamanos,
President, Federata e Ekspertëve të Kontabilitetit të Mesdheut (FCM)



PËRMBAJTJA

Lindja e ShKÇAK.....	08
Krijimi i kapaciteteve të ShKÇAK.....	12
SHKÇAK - qendër e ekselencës.....	14
Sinergjia, puna ekipore, përkushtimi dhe dedikimi i anëtarëve të bordit, komisioneve dhe zyrës ekzekutive është çelësi i suksesit në ShKÇAK.....	26
Pajtueshmëria e shkçak me kërkesat e ligjit për kontabilitet raportim financiar dhe auditim.....	35
ShKÇAK – pjesë e federatave ndërkombëtare.....	37
Anëtarësimi në federatën e ekspertëve të kontabilitetit të mesdheut (FCM).....	41
Anëtarësimi në federatën evropiane të kontabilistëve dhe auditorëve për ndërmarrje të vogla dhe të mesme/EFAA....	43
Mbështetja e vazhdueshme për sektorin publik drejt rritjes së transparencës, llogaridhënies dhe implementimit të standardeve të cilësisë së lartë.....	49
Bashkëpunimi me institucione dhe donatorë për ngritje të kapaciteteve dhe zhvillimin e trajnimeve specifike.....	53
Bashkëpunimi me odat ekonomike.....	59
Bashkëpunimi me institucionet arsimore.....	60
Bashkëpunimi me institucione ndërkombëtare.....	69
COVID19 - Sfidë që e karakterizoi fundin e dekadës së dytë.....	72
ShKÇAK - Rruga përpara.....	74



LINDJA E SHKÇAK

Themelimi i Shoqatës filloi të planifikohej në një kohë kur një pjesë e madhe e popullatës në Kosovë ballafaqohej me pasojat e luftës, shtëpi të rrënuara, ekonomi të shkatërruar, situatë të rëndë humanitare.

Rehabilitimi i procesit të edukimit në fillim të vitit 2000 ishte ndër prioritetet e para në vend, të mbështetura nga organizata të huaja ndërkombëtare.

Profesionistët e vendit së bashku me Bankën Botërore dhe USAID bashkëpunuan me qëllim të themelimit të një shoqate profesionale që me mision do t'i kushtojë rëndësi zhvillimit të profesionit të kontabilitetit dhe auditimit përmes edukimit dhe programeve certifikuese në fushën e kontabilitetit dhe auditimit.

Ndihma jo vetëm financiare por edhe ajo teknike nga donatorët ndërkombëtarë ishte thelbësore për fillimin e rrugëtimit të ShKÇAK që ishte mjaft sfidues.





“Tani kur kanë kaluar 20 vite të funksionimit të Shoqatës besoj se ia kemi dalë që të krijojmë një pozitë dhe një rol të rëndësishëm për profesionistët e kontabilitetit dhe auditimit. Vendimet ekonomike në secilën ndërmarrje serioze ekonomike duhet të kenë inputin tonë. Informatat financiare të një kontabilisti etik janë kyçe sa i përket vendimeve të mëdha investive pavarësisht se a bëhet fjalë për vendime bankare, investitorëve potencial apo vendimeve ligjore e tatimore. Është detyrë e jona që tani në periudhën e ardhshme të asistojmë në zhvillimin ekonomik duke ofruar një platformë të raportimit dhe sigurisë financiare që i përgjigjet standardeve më të larta ndërkombëtare.”

Lekë Musa,
Themelues, Kryetar i parë i Këshillit

Banka Botërore ka ndihmuar në aspektin financiar dhe teknik për themelimin e ShKÇAK, dhe në krijimin e kornizës ligjore financiare të Kosovës, përpilimit të Rregullores për Themelimin e Bordit për Raportimin Financiar të Kosovës dhe të një regjimi për raportim financiar të organizatave afariste në Kosovë, duke përfshirë edhe çertifikimin e kontabilistëve dhe licencimin e revizorëve. Bazuar në këtë Rregullore u formua Bordi Kosovar për Standarde të Raportimit Financiar, si dhe u krijua baza ligjore për themelimin e ShKÇAK-së.

“ShKÇAK rritet me shumë ndihmë, këshilla dhe këmbëngulje nga shumë burime (jo të pakta ishin përpjekjet e stafit të vet si dhe anëtarëve të hershëm) dhe tani është rritur, është një “gjë” e re dhe e mençur. Kjo është diçka që më bën të jem shumë krenarë që jam e lidhur me të. Nuk është shumë e shpeshtë që një këshilltar të shohë një sukses për një periudhë kaq të shkurtër.”

Thuy Mellor,
Ish këshilltare dhe bashkëpunëtore e ShKÇAK



Në vitin 2002, Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillimin Ndërkombëtar (USAID) përmes programit Përkrahja e Biznesit Kosovor (PBK/KBS), iu bashkuan historisë duke ndihmuar ShKÇAK-në që të krijonte planprogramin e saj fillestar i cili synonte të edukonte kontabilistët dhe studentët për standarde ndërkombëtare të kontabilitetit dhe auditimit.

Jan Tyl udhëhoqi ekipin e parë të asistencës teknike për të filluar me trajnimet.



"ShKÇAK u themelua si një projekt në kuadër të projekteve të tjera. Tekstet e para, ligjëratat dhe provimet ishin në thelb një koleksion i kërkimeve në internet. Të shumtë ishin ata që tentuan ta injoronin apo edhe ta dëmtonin ShKÇAK-në atëherë. Suksesi i parë ishte anëtarësimi i asociuar në FNK dhe edhe ai nuk kaloi pa sfida. Është pothuajse e pabesueshme se sa është arritur nga ShKÇAK që nga ajo kohë e deri më sot; ShKÇAK duhet t'i prezantohet botës si një shembull se çfarë mund të arrihet përmes mbështetjes sistematike për zhvillim. Natyrisht, të gjithë elementët përbëhen nga - entuziazmi, ambicia, vetëmohimi dhe përkushtimi. Në ShKÇAK, gjithmonë kanë ekzistuar të gjitha këto."

Jan Tyl,
Anëtar themelues i SHKÇAK, Ish - Këshilltar në USAID dhe Bankën Botërore

Një rol të madh në këtë periudhë luajtën Znj. Silvia Minotti dhe Znj. Silvia Mauri, të cilat kontribuan jo vetëm si personel i Bankës Botërore, por edhe ishin zëri i Shoqatës në institucionet relevante vendore dhe ndërkombëtare.




"Ajo ditë... ende e kujtoj atë ditë... takimin tonë të parë me ShKÇAK... ShKÇAK ishte një nga institucionet që mbështetej nga ky projekt financiar nga Banka. Në atë kohë, ShKÇAK dhe ne i kishim zyrat në të njëjtën ndërtesë. Takimi ynë ishte më shumë se i mjaftueshëm që ne, skuadra e re e Bankës, të kuptonte se ShKÇAK do të ishte një institucion fitues, një organizatë e shëndoshë dhe me reputacion të shkëlqyeshëm, e cila do të ishte e aftë të funksiononte në një mjedis të vështirë e që do të kapërcente pozitivisht të gjitha vështirësitë ose problemet."

Silvia Minotti,
Banka Botërore

"Ka shumë e shumë kujtime nga koha që kam kaluar në Kosovë dhe të përpjekjeve të përditshme të personelit të ShKÇAK, nën udhëheqjen e Ardianës... ajo që më pëlqen më tepër të sjell ndërmend, dhe që më bëri të besoj se me të vërtetë këta njerëz do t'ia dilnin mbanë, është serioziteti me të cilin u trajtua organizimi i provimeve, duke filluar nga përgatitja e materialeve dhe pyetësorëve, deri tek ruajtja dhe logjistika përkatëse për të garantuar kështu sjelljen në jetë në mënyrën e duhur e të përshtatshme të vlerave që përfaqësojnë certifikatat e lëshuara nga ShKÇAK."

Silvia Mauri,
Banka Botërore



KRIJIMI I KAPACITETEVE TË ShKÇAK

Gjatë vitit 2002 në Shoqatë u punësua Znj. Ardiana Bunjaku me qëllim të krijimit dhe menaxhimit të Zyrës Ekzekutive të ShKÇAK.

Filloi edhe punësimi i stafit tjetër që bashkërisht krijuan bazat e zhvillimit modern të institucionit duke vazhduar me mbështetjen e principeve të qeverisjes së mirë të Shoqatës deri në ditët e sotme.

Zyra ekzekutive e ShKÇAK me staf të dedikuar dhe profesional ishte shtylla kryesore e zhvillimit ndër vite.

Puna e zyrës ekzekutive nën udhëheqjen 20 vjeçare të Drejtoreshës ekzekutive, Znj. Ardiana Bunjaku ka bërë të mundur ngritjen e imazhit të Shoqatës. Kjo është arritur përmes zhvillimit të profesionit të kontabilitetit dhe auditimit në Kosovë, promovimit të vlerave profesionale në arenën ndërkombëtare përmes anëtarësimit dhe përfaqësimit në organizatat më të mëdha në fushën e kontabilitetit dhe auditimit.




“Krijimi i një zyre të fortë ekzekutive dhe bashkëpunimi i këshillit të parë dhe zyrës ekzekutive ishte momenti kyç në përcaktimin e procesit të zhvillimit të shoqatës. Kjo sinergji në mes të zyrës ekzekutive dhe të gjithë këshilleve të ardhme, e ka ngritur dhe në vazhdimësi po e mban shoqatën në nivelin më të lartë.”

Bashkim Uka,
Kryetar i Këshillit
2002-2005



“Edhe pse kam kaluar 25 vite duke punuar në zhvillimin e shoqatave profesionale në shumicën e kontinenteve, ShKÇAK përfaqëson përvojën më shpërblyese për shkak të përkushtimit 100% dhe të dëshirës së Këshillit dhe stafit të ShKÇAK që të arrijë sukses. Shumë pak përfitues të projekteve motivojnë konsulentët të punojnë 24 orë në ditë e 7 ditë në javë, por është e vështirë për ndonjë profesionist të zhvillimit të shkojë në shtëpi në ora 18:00 në mbrëmje kur njerëzit e tillë të dedikuar vazhdojnë të punojnë deri në orët e vona.”

Liam Coughlan
Ish udhëheqës i ekipit, Projektet e BE



ShKÇAK - Qendër e Ekselencës

Zhvillimet vendore, sidomos kërkesat e institucioneve shtetërore të Kosovës kanë orientuar Shoqatën që të krijoj një diversitet të shërbimeve dhe kontribuoj në zhvillimin e ekonomisë në Kosovë. Në këtë aspekt, ShKÇAK ka arritur njërën ndër synimet kryesore të strategjisë së saj, duke u bërë Qendër e Ekselencës për zhvillimin e programeve certifikuese sipas kërkesave të tregut për sektorin privat dhe publik.

Në vitin 2002 filloi programi i ShKÇAK-së për certifikimin në thirrjet: teknikë të kontabilitetit, kontabilistë të certifikuar dhe më pastaj auditorëve të licensuar, pas miratimit të tij nga Bordi Kosovar për Standardet e Raportimit Financiar.

Trajnimi i parë me studentë për thirrjen "Teknik Kontabiliteti" ka filluar më 1 Prill 2002 në Prishtinë. Numri i përgjithshëm i studentëve ishte 139. Trajnimet filluan të mbahen edhe në komunat e tjera të Kosovës duke filluar në Mitrovicë, Prizren, Gjiilan, Ferizaj.

SHKÇAK qysh nga themelimi ka përkrahur trajnimin dhe zhvillimin e të gjitha grupeve etnike, racore dhe gjinore në Kosovë. SHKÇAK ka filluar me trajnimet në rajonet ku jetonin minoritetet dhe si rezultat i kësaj janë regjistruar 28 kandidatë.



Deri në fund të vitit 2002, janë trajnuar 392 studentë .

26 studentë kanë përfunduar nivelin e parë “Teknik Kontabiliteti”, ndërsa 9 nga të cilët i kanë përfunduar nivelin e dytë “ Kontabilistë të çertifikuar”.


Në fund të vitit 2003, të regjistruar në trajnimin për “Teknik Kontabiliteti” kanë qenë 461 studentë, nga të cilët 130 studentë kanë përfunduar këtë nivel, 78 janë regjistruar në nivelin e dytë për “ Kontabilistë të çertifikuar” nga të cilët janë 55 janë çertifikuar.

SHKÇAK në fund të vitit 2003 gjithashtu mbajti trajnime në nivelin e parë edhe për stafin e financave në OSBE-zyra në Kosovë.




Me themelimin e Zyrës së Auditorit Gjeneral nevoja për ngritje të kapaciteteve profesionale për të funksionalizuar zyrën iu besua SHKÇAK-ut. Pas nënshkrimit të marrëveshjes me zyrën e Auditorit Gjeneral në Kosovë, të gjithë auditorët e punësuar në këtë institucion duhej të certifikoheshin në SHKÇAK. Trajnimet e para për nivelin teknik i kontabilitetit kanë filluar në fund të vitit 2003 me 20 studentë. Trajtime të tilla dhe bashkëpunimi ndër-institucional vazhdon ndër vite duke kontribuar në ngritjen e nivelit profesional brenda këtij institucioni mjaft të rëndësishëm në Republikën e Kosovës.

Në fillim, përgatitja e materialeve të trajnimeve ishte proces mjaft sfidues duke filluar nga botimi i librave të dizajnuara më thjeshtë e deri në ditët e sotme kur kemi një literaturë të avancuar dhe të përditësuar konform standardeve më të larta ndërkombëtare, si rezultat i bashkëpunimit me institucione kredibile të edukimit në botë.



SHKÇAK filloi edhe botimin periodik të revistës “Kontabiliteti Bashkëkohor” gjatë vitit 2003, e cila i dedikohet sidomos komunitetit të kontabilistëve dhe auditorëve. Kjo revistë publikonte opinionet, raportet, analizat tatimore, standardet dhe udhëzuesit e lëshuar nga standard vënësit global që ishin në interes të profesionit dhe zhvillimit ekonomik në Kosovë.

Ndër vite, shtrirja e përdorimit të rrjeteve sociale ka mundësuar që ShKÇAK të jetë edhe më afër anëtarëve të saj duke i informuar me kohë për zhvillimet e reja në lidhje me profesionin e kontabilitetit dhe auditimit, për plotësimet dhe ndryshimet ligjore si dhe standardeve të lëshuara nga standard-vënësit në nivel ndërkombëtar.



ShKÇAK ishte orientuar dhe angazhohej fuqishëm për të ofruar trajnime të bazuara në standardet dhe praktikat më të mira me qëllim që, para së gjithash, Kontabilistët dhe Auditorët e certifikuar të jenë profesionalisht në nivel të njëjtë me kolegët e tyre në vendet e zhvilluara ekonomikisht dhe të kontribuojnë në institucionet ku punojnë për ngritjen e transparencës financiare dhe etikës profesionale.

Pas pranimit të ShKÇAK-së në FNK si Anëtar i Asociuar në vitin 2003, Anëtarët e Shoqatës u zotuan që të vazhdojnë në implementimin dhe fuqizimin e standardeve ndërkombëtare, udhëzimeve dhe praktikave më të mira globale për profesionin konform Deklaratave të Obligimeve të Anëtarësisë (DOA) të FNK-së.

ShKÇAK është përkushtuar të gjej mentor për implementimin e kërkesave të dala nga FNK për të arritur sa më shpejt anëtarësimin e plotë në FNK.

Në vitin 2004 vazhduan trajnimet për auditorë të licencuar duke mundësuar që në vitin 2005 të certifikohen 40 auditorë të rinj.

Që nga viti 2002 deri më fund të vitit 2021 numri i studentëve që kanë përfunduar me sukses certifikimet janë: 1,738 teknik kontabiliteti, 651 kontabilistë të certifikuar dhe 255 auditor të certifikuar.

Në vitin 2005 ShKÇAK implementoi planprogramin e dytë, duke orientuar më tej programin e saj profesional me praktikat më të mira ndërkombëtare, dhe duke pasqyruar standardet dhe vlerat e FNK-së.

SHKÇAK krijoi shpejt besueshmëri të lartë për sistemin e saj të provimeve, duke përshtatur dhe implementuar menjëherë Manualin Këshillues për Administrimin e Provimeve të FNK-së(IFAC) në Kosovë.

SHKÇAK ka vazhduar me certifikimin dhe mbajtjen e trajnimeve në fusha më specifike që ndërlidhen me specialistë të insolvencës në vitin 2009.

Si pjesë e punës së vazhdueshme në ShKÇAK, gjatë vitit 2017 është lansuar programi “Auditor i Brendshëm i Certifikuar” i ofruar për herë të parë në Kosovë duke u mbështetur në materialet e Institutit Ndërkombëtar të Auditorëve të Brendshëm nga botuesi Wiley.

Gjatë vitit 2017 janë zhvilluar plan programet dhe materialet për dy nivele të programit certifikues: Ekspert Tatimor dhe Ekspert i Lartë Tatimor, të cilat kanë filluar implementimin nga viti 2018. Gjithashtu, gjatë këtij viti ka filluar implementimi i Programit “Ekspert i Licencuar i Forenzikës Financiare”.





"Me Shoqatën më lidhin kujtimet që nga fillimet e saj.

Isha i punësuar në një projekt të USAID-it, Kosovo Business Support/KBS dhe na vjen një kërkesë prej menaxhmentit të projektit se duhet të fillojmë me përgatitë materialet për programin e certifikimit të ShKÇAK. Nuk kishim dëgjuar më pare se ekzistonte një shoqatë e tillë, dhe cili ishte misioni i saj.

Ishim katër veta në departamentin e kontabilitetit në KBS kurse udhëheqësi ynë ishte Jan Tyl. Më vone e kemi kuptuar që Jan Tyl ishte edhe njëri prej themeluesve të Shoqatës.

Nga Jani ne i morëm udhëzimet se ku duhet t'i marrim materialet si brumë për t'i përgatitur materialet e para për ligjërata. Ishte një sfidë e veçantë përkthimi i materialeve, përgatitja e tyre në formën e librit dhe përgatitja e prezantimeve në PowerPoint.

Pasi i përgatitëm materialet dhe i printuam, filloi angazhimi ri për ekipin e KBS-it, përkthimi i ligjëratave.

Në ligjëratat e para, si ligjërues ishte Jan Tyl, dhe unë, sikurse edhe kolegët e mi, isha përkthyes i tij, dhe natyrisht ishte sfidë përkthimi, për shkak se nuk e kisha atë si profesion, por po ashtu edhe kuptimi dhe përkthimi i të gjithë terminologjisë në gjuhën shqipe ishte sfidë në vete.

Pavarësisht të gjitha këtyre problemeve fillestare, programi i certifikimit nisi me sukses, prezenca e studenteve ishte masive, pastaj filluan edhe provimet e para, si dhe vazhduam me grupe tjera edhe në të gjitha regjionet e Kosovës.

Thonë se dita e mirë shihet në mëngjes.

Ne e filluam mbarë rrugëtimin tonë dhe ky rrugëtim vazhdon edhe sot, me kontributin dhe punën e palodhshme të zyrës ekzekutive dhe këshillit, komisioneve të Shoqatës dhe anëtarëve të saj, dhe të ndihmuar pa rezervë nga donatorët e jashtëm si Banka Botërore, USAID dhe BE.

Kemi krijuar dhe mirëmbajtur një Shoqatë e cila ka fituar dhe e mban një reputacion të mirëfilltë kombëtar dhe ndërkombëtar në zbatimin e standardeve më të larta etike dhe profesionale, dhe në shërbim të plotë të anëtarëve të saj.

Jam i bindur se ky rrugëtim do të vazhdojë edhe në të ardhmen me kontributin e gjeneratave të reja që po vijnë në Shoqatë."

Nazmi Pllana, Nën Kryetar Bordit, 2021

Kryetar i Këshillit

2005-2007, 2010-2012, 2016-2018

Në vitin 2007, përmes programit të implementuar nga Carana Corporation dhe të financuar nga USAID për "Krahasimin me Standardet Ndërkombëtare të Transparencës dhe Kontabilitetit", ShKÇAK ka nënshkruar marrëveshje të binjakëzimit me Royal NIVRA, Institutin Holandez të Kontabilistëve të Certifikuar. Sipas kësaj marrëveshjeje, Royal NIVRA ka mbikëqyrur dhe udhëzuar Shoqatën në implementimin e plotë të DOA-ve.

ShKÇAK që nga themelimi është orientuar dhe ka punuar në:

- krijimin e një sistemi të Qeverisjes së mirë organizative,
- reformimin e programit certifikues konform Standardeve Ndërkombëtare të Edukimit (SNE),
- krijimin dhe zhvillimin e një sistemi të qëndrueshëm të sigurimit të cilësisë.

ShKÇAK ka vazhduar të punojë në përforcimin e marrëdhënieve me komunitetin e donatorëve pa të cilët do të ishte i pamundur implementimi i projekteve ambicioze që ShKÇAK kishte për synim.



Në vitin 2007, ShKÇAK ishte përfitues i Projektit "Raportimi financiar i organizatave biznesore në Kosovë", financuar nga Agjensioni Evropian për Rindërtim (AER) i udhëhequr nga Z. Laim Coughlan. Ky projekt ndihmoi ShKÇAK-në të implementojë planprogramin e ri sipas SNE-ve dhe gjithashtu ndikoi pozitivisht tek të gjitha palët tjera me interes të involvuar në implementimin e standardeve, udhëzimeve dhe praktikave më të mira sipas direktivave të Bashkimit Evropian.

Projekti gjithashtu ndihmoi Shoqatën drejt krijimit të kapaciteteve të ligjëruesve përmes trajnimit të trajnerëve, të mbajtura nga trajnerët e organizatave ndërkombëtare. Në këtë drejtim, Shoqata ka qenë gjithmonë e hapur ndaj ligjëruesve me përvojë të cilët janë të orientuar drejt edukimit profesional të studentëve duke u bazuar në literaturën më bashkëkohore dhe përvojat e institucioneve më eminente ndërkombëtare. Departamenti i Edukimit të ShKÇAK-së mbetet i përkushtuar me qëllim të përsosjes së trajnimeve, mbarëvajtjes së ligjëratave dhe provimeve si dhe bashkëpunimin me studentë dhe anëtarë.

Programi i ri i edukimit profesional i ShKÇAK ishte lansuar në shtator 2008. Plan programi i ri i auditimit dhe kontabilitetit në Kosovë ishte zhvilluar nga ekipi i ShKÇAK në bashkëpunim me projektin e Raportimit Financiar mbi Korporatat të menaxhuar nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian duke plotësuar kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Edukimit 2 dhe 8, si dhe seksioneve relevante të Direktivës së Tetë të BE-së.



Një komponentë shumë e rëndësishme e këtij projekti është edhe arritja e marrëveshjes në mes të ShKÇAK dhe botuesit britanik BPP Learning Media për marrjen e ekskluzivitetit për përkthimin dhe përdorimin e materialeve të ACCA. BPP Learning Media është një nga ofruesit e materialeve studimore për kualifikimet profesionale në lëminë e kontabilitetit dhe auditimit më cilësore në nivel global.



BPP Learning Media ka shpërblyer ShKÇAK me çmimin akreditues “BPP Solutions Provider”, i cili ka për qëllim të vlerësojë faktin që ShKÇAK përveç që ofron ligjërime të shkëlqyeshme, ofron edhe materialet e cilësisë më të lartë për studentët e saj.



“Një planprogram i cilësisë së lartë, i bazuar në standardet më të larta ndërkombëtare, shoqëruar me mbështetjen profesionale për ligjëruesit ka përmirësuar performancën e studentëve ndër vite. Zhvillimi profesional dhe edukimi i vazhdueshëm ka qenë vlerë e shtuar në Shoqatë dhe ka qenë thelbësor në promovimin tonë ndërkombëtar.”

Lulzim Zeka,
Kryetar i Komisionit të Edukimit dhe Standardeve Profesionale

Njësimi i praktikave dhe kriterëve që bazohen në Standardet Ndërkombëtare të Edukimit të FNK-së ndikoi që kualifikimet e arritura në ShKÇAK të mirëpritën nga sektori privat dhe publik dhe që anëtarët e Shoqatës të jenë shembull i etikës dhe profesionalitetit në ekonominë e vendit. ShKÇAK, si qendër e ekselencës, ishte institucioni i parë inovativ të zhvillimit të programit certifikues për sektorin publik dhe privat, duke përfshirë specializimet specifike që ngrisin dhe mirëmbajnë avancimin profesional për anëtarët e saj.



Shoqata i mban anëtarët të përditësuar me zhvillimet e fundit të profesionit përmes sistemit të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional dhe siguron cilësinë e shërbimeve të ofruara nga anëtarët përmes menaxhimit të cilësisë.



Edukimi i Vazhdueshëm Profesional ka pikësynim themelor për të siguruar cilësinë profesionale të anëtarësisë në mënyrë që anëtarët të jenë gjithmonë në trend me zhvillimet më të reja globale. Shoqata gjatë tërë kohës ka angazhuar ekspertë vendor dhe ndërkombëtar që kanë kontribuar në avancimin dhe zgjerimin e njohurive në fushat përkatëse për anëtarët e saj.



Duke e marrë për bazë dinamikën e zhvillimit të profesionit dhe Shoqatës, në vazhdimësi është paraqitur nevoja e rishikimit të Statutit dhe plotësimit të akteve normative, duke mbetur të palëkundur dhe të fokusuar në misionin e saj për mbrojtjen e interesit publik dhe zhvillimin e profesionit të kontabilitetit dhe auditimit në Kosovë.

Anëtarët e Shoqatës ishin zotuar që të vazhdojnë në implementimin dhe fuqizimin e standardeve ndërkombëtare, udhëzimeve dhe praktikave më të mira globale për profesionin konform Deklaratave të Obligimeve të Anëtarësisë (DOA) të FNK-së.



Implementimi i sistemit të menaxhimit të cilësisë për pajtueshmëri me standardet e kërkuara nga DOA1 ishte një sfidë në vete. Në bashkëpunim me Institutin Royal Nivra dhe projektin PUM Ekspertët, në kuadër të ndihmës nga qeveria holandeze, në vitin 2010 filloi projekti për zhvillimin e sistemit të sigurimit të cilësisë, i cili kishte për synim zhvillimin e manualeve dhe kapaciteteve njerëzore brenda shoqatës, ofrimin e programeve të ndryshme për profesionistët në praktikë duke vazhduar me themelimin e Komisionit dhe Departamentit për menaxhimin e cilësisë.




“NBA (OPK e Holandës) dhe partnerët e saj nga PUM, punuan ngushtë së bashku me SHKÇAK-në që nga viti 2007. Aso kohe SHKÇAK ishte një organizatë e re, për një profesion të ri në një vend të ri që përballej me sfida të mëdha. Roli ynë ishte modest: ofrimi i udhëzimeve, asistencës teknike dhe këshillimit. SHKÇAK ishte në mënyrë proaktive në pozicion drejtues. Anëtarësimi i plotë në FNK ishte një arritje e madhe që rezultoi në njohjen ndërkombëtare të profesionit në Kosovë. SHKÇAK tregoi se ecja në hap me kohën drejt së ardhmes është e mundur vetëm me ngritjen e kapaciteteve strukturore në aspektin e organizatës, arsimit, kulturës së biznesit, përvojës në profesionit të kontabilitetit me fokus në interesin publik. FNK vlerësoi shembullin e Kosovës me Drejtoreshën Ekzekutive, Ardiana Bunjakun duke zgjedhur anëtare në Komitetin e Zhvillimit të OPK të FNK. Pasi që, sfida të reja do të ketë në të ardhmen; atëherë kemi parasysh kërkimin në rritje vetëdijesimit të shoqërisë për rolin e profesionit në luftën kundër mashtrimit, vazhdimësisë së bizneseve dhe qëndrueshmërisë. Me besim të plotë në SHKÇAK si një partner i besueshëm në profesionin ndërkombëtar për tejkalimin e këtyre sfidave dhe sfidave të reja, dëshiroj të falënderoj Ardiana Bunjakun për fokusin, energjinë, partneritetin dhe e fundit por jo më pak e rëndësishme ‘miqësinë’ në të gjitha vitet e kaluara.”

Paul Hurks,
Drejtor i Kontabilitetit Ndërkombëtar në Organizatën Profesionale të Kontabilistëve të Holandës- Amsterdam (NBA)

Menaxhimi i Cilësisë për Pajtueshmëri me Standardet (MCPS) ka ndihmuar për të siguruar që anëtarët e Shoqatës zbatojnë të gjitha kërkesat ligjore dhe kërkesat e standardeve ndërkombëtare dhe praktikatat më të mira të profesionit, njëkohësisht duke ndihmuar në ruajtjen e reputacionit të anëtarëve dhe duke shtuar besimin e përdoruesve të raporteve të auditimit dhe pasqyrave financiare.



Duke qenë në hap me zhvillimin e teknologjisë, ShKÇAK ka zhvilluar brenda Departamentit të Menaxhimit të Cilësisë për Pajtueshmëri me Standardet digjitalizimin e procesit të raportimit vjetor për anëtarët e saj.



SINERGJIA, PUNA EKIPORE, PËRKUSHTIMI DHE DEDIKIMI I ANËTARËVE TË BORDIT, KOMISIONEVE DHE ZYRËS EKZEKUTIVE ËSHTË ÇELËSI I SUKSESIT NË SHKÇAK

ShKÇAK që nga themelimi ka promovuar qeverisjen e mirë, duke krijuar mekanizma dhe struktura me qëllim të transparencës dhe llogaridhënies ndaj anëtarëve dhe publikut të gjerë.

Në Bordin e Shoqatës gjithmonë janë angazhuar profesionistë me përvojë të gjatë në fushën e kontabilitetit, auditimit, qeverisjes dhe menaxhimit financiar nga të gjithë sektorët ekonomik të Republikës së Kosovës, të cilët kanë luajtur rol të rëndësishëm në të gjitha proceset qysh nga themelimi i ShKÇAK.

Të gjitha aktivitetet dhe vendimet nga anëtarët e Këshillit (tani Bordit) ndër vite kanë qenë të bazuara në interesin më të mirë të Shoqatës dhe duke siguruar që të gjitha standardet ligjore dhe etike janë respektuar.

Anëtarët e Bordit me punën dhe përkushtimin e tyre kanë qenë të fokusuar drejt një të ardhmeje të qëndrueshme duke miratuar politika të shëndosha, etike dhe ligjore të qeverisjes, si dhe duke u siguruar që ShKÇAK si organizatë jofitimprurëse profesionale të ketë burime të mjaftueshme për të çuar përpara misionin e saj dhe në mënyrë të vazhdueshme të përmbushë objektivat afatshkurtra dhe afatgjata për studentët dhe anëtarët e saj.



Komisionet e ShKÇAK-së luajnë rol kyç në arritjen dhe zhvillimin e qëllimeve, objektivave dhe aktiviteteve të Shoqatës. Në kuadër të strukturës organizative ShKÇAK ka formuar Komisionet në vijim: Komisioni për Nominime, Komisioni për Auditorë Ligjor, Komisioni për Kontabilistë të Çertifikuar, Komisioni për Menaxhimin e Cilësisë në Pajtueshmëri me Standardet, Komisioni për Edukim Profesional, Komisioni për Standarde Profesionale, Komisioni për Sjellje dhe Disiplinë, Komisioni për Insolvencë dhe Komisioni për Tatime.

Një hap shumë i rëndësishëm është themelimi dhe puna e komisioneve të cilat domosdoshmërisht ishin edhe bartës të zhvillimit të segmenteve funksionale të Shoqatës dhe mundësi për zgjerimin e pjesëmarrjes së anëtarëve në qeverisjen e Shoqatës. Komisionet shërbejnë si urë lidhëse në mes të anëtarëve dhe akterëve pjesëmarrësve relevantë të profesionit në krijimin e një mjedisi të shëndoshë për kontabilistët dhe auditorët.



Në vazhdimësi, Shoqata nëpërmes zyrës ekzekutive ka promovuar qeverisjen e mirë duke krijuar linja të forta komunikimi me studentët dhe anëtarët dhe është angazhuar në drejtim të ofrimit të shërbimeve cilësore në trajnime, edukim të vazhdueshëm, kontrollë të cilësisë dhe duke motivuar profesionistë të fushës për angazhimin e tyre në implementimin dhe fuqizimin e standardeve ndërkombëtare dhe përmirësimin e cilësisë së performancës. Nga zyrat e ShKÇAK janë promovuar shumë profesionistë të cilët janë angazhuar dhe kontribuojnë në të gjithë sektorët e ekonomisë së vendit.

Stafi në zyrën ekzekutive ka qenë i përkushtuar në promovimin e vlerave më të larta profesionale dhe etike gjatë angazhimit 20 vjeçar duke bërë ShKÇAK-në një institucion kredibil jo vetëm brenda vendit, por të njohet edhe si shembull i zhvillimit të profesionit në nivel global.





"Për zhvillim të organizatës profesionale kërkohet shumë energji, inovacion dhe etikë të lartë profesionale. Asgjë nuk ndodh vetvetiu i gjithë ky zhvillim bëhet me punë të madhe dhe përkushtim e këtë më së miri e bën një staf i përkushtuar si ai i zyrës Ekzekutive të SCAAK."

Ardiana Bunjaku
Drejtoreshë ekzekutive

"Kur e fillova punën në SHKÇAK as që kam mendu që sëbashku kemi me i "plakë" 20 vjet...ndjenjë e veçantë me qenë pjesë e historisë, me taku njerëz të mirë e me mbetë me kujtime të mrekullueshme."

Lendita Shahini-Ustaibo
Udhëheqëse e Administratës dhe BNJ



*"Puna ime në ShKÇAK-është ngusht e lidhur me anëtarët dhe studentët me të cilët kam përjetuar gëzimin e suksesit nga provimi i parë e deri tek çertifikimi. Të përjetosh suksesin e gjeneratave ndër vite duke ju bashkuar tringut të profesionistëve të ShKÇAK të bën të besosh se përkushtimi dhe etika profesionale çdo herë kurorëzohen me sukses!
Ndihe me nderuar që jam pjesë e një kolektivi ku më së shumti vlerësohet besimi, dija nuk shitet e as nuk blihet, ajo dhurohet dhe përfitohet dhe këtë ShKÇAK e bën mirë dhe me nder."*

Burbuqe Gjonbalaj
Udhëheqëse e Departamentit të Shërbimit për Anëtarë



"Gjysmën e rrugëtimit 20 vjeçar të ShKÇAK e kemi bërë së bashku, jam rritur me të, sepse hapat e parë të karrierës dhe punës i kam filluar në ShKÇAK. Kam qenë pjesë e zhvillimeve kryesore dhe dëshmitare e punës së madhe që është bërë, si nga aspekti i krijimit dhe zhvillimit të programeve të reja të edukimit që janë marrë pastaj si model nga shoqatat tjera, ashtu edhe për nga krijimi i bashkëpunimeve të shumta me institucione vendore dhe ndërkombëtare.

ShKÇAK ka staf të vogël në numër por me punë dhe zemër të madhe. Sukses i nuk vie brenda natës, por me përkushtim, dedikim dhe mund, andaj ShKÇAK është shembulli më i miri për këtë gjë.

Jam krenare të jem pjesë e familjes së madhe ShKÇAK!"

Edona Perjuci

Eksperte e Edukimit dhe Standardeve Profesionale

"ShKÇAK arriti një sukses të jashtëzakonshëm. Jam krenar që së bashku zgjeruam programet për certifikim të auditorëve të brendshëm, arritëm të zhvillojmë dhe implementojmë një sistem të mirëfilltë të menaxhimit të cilësisë për anëtarët e shoqatës, kontribuam në përmirësimin e ligjit për kontabilitet, auditim dhe raportim financiar, si dhe rregulluam profesionin e kontabilistit duke ndikuar kështu në rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe ruajtjen e interesit publik."

Arbër Hoti

Ekspert i sigurimit të cilësisë



"Jeta e njeriut plotësohet me dashurinë që e merr dhe e jep ndaj më të dashurve të tij. Ajo bëhet më e plotë kur këtë ndjenjë e ndan edhe me rrethin ku jeton dhe vepron. Këtë ndjenjë e kam përjetuar gjatë gjithë këtyre viteve duke qenë në mesin e njerëzve me kredibilitet, potencial profesional dhe përkushtim etik. Kjo, neve si pjesë e SHKÇAK na jep komoditetin që të ndihemi krenar dhe qëndrojmë ballëlartë për vlerat që i kemi dhënë profesionit të kontabilitetit dhe auditimit në Kosovë."

Burim Ahmeti

Udhëheqës ligjor



"Transparenca dhe qëndrueshmëria financiare, fryma bashkëpunuese, profesionalizmi dhe mbështetja e vazhdueshme e stafit për anëtarët është çelësi kryesor i suksesit të Shoqatës. Rrugëtimi im në ShKÇAK ka filluar si studente ku më pas pata fatin të jem pjesë e stafit.

Duke qenë kështu pjesë e kësaj shtëpie të madhe profesionistësh është privilegj dhe njëkohësisht përgjegjësi. Shoqata për mua që nga fillimi ka qenë dhe vazhdon edhe sot e kësaj dite të jetë ndër përvojat më të bukura dhe më dobiprurëse të karrierës sime."

Rina Sejdiu
Zyrtare e Financave

"Është privilegj dhe kënaqësi t'u shërbej studentëve të rinj që nga shprehja e interesimit të tyre e deri në arritjet e tyre më të larta. Të dëgjosh dhe përjetosh nga afër kërkesat e tyre është puna ime që e bëj me kënaqësi si pjesë e Shoqatës, në të cilën cilësia është ndër vlerat më të larta."

Dafina Osmani
Zyrtare e shërbimit për studentë



"Puna në ngritjen e cilësisë së shërbimeve të auditimit dhe raportimit financiarë të anëtarëve të shoqatës është sa sfiduese po aq edhe përmbushëse. Jam e lumtur që me shumë punë dhe përkushtim, së bashku me anëtarët e shoqatës po ndikojmë në rritjen e besueshmërisë së raportimeve financiare në Kosovë. Përpara nesh na pret një e ardhme më komplekse por më e ndritur. Të jem pjesë e ShKÇAK është nder dhe privilegj për mua."

Liridona Sopa
Zyrtare për Menaxhim të Cilësisë në Pajtueshmëri me Standardet



Vlera e një organizate duhet parë në atë se çfarë ajo organizatë ofron. ShKÇAK e ka dëshmuar këtë vlerë, duke ofruar çdo herë programe profesionale të nivelit të lartë, duke zbatuar dhe promovuar standarde dhe praktika globale nga më profesionalet, duke asistuar në të mirë të interes publik dhe mbi të gjitha duke orientuar dhe ndryshuar përgjithmonë sistemin e profesionit të kontabilitetit dhe auditimit në vendin tonë.

ShKÇAK është investimi i duhur në profesionistët e së ardhmes, gjë që është dëshmuar tash e 20 vite. Ndiem krenare që jam pjesë e ekipit!

Enkela Gjata
Zyrtare për Informim dhe Komunikim

“Një fokus shumë i rëndësishëm i tërë stafit administrativ është përmbushja e kërkesave dhe ofrimit të kushteve sa më të mira gjatë mbajtjes së ligjëratave dhe provimeve. Pas çdo pune të kryer, fjalët e mira dhe diskutimet me studentët më bëjnë të ndihem i lumtur që jam pjesë e ShKÇAK. Nuk është i rastësishëm sukcesi i arritur ndër vite. Do të mbesim shembull i suksesit.”

Avni Iseni
Zyrtar për Logjistikë



“Edhe pas më shumë se 12 vitesh nuk mund të formuloj shprehje të shkruar në të cilën mund të futen të gjitha emocionet e përjetuara atë ditë nëntori të vitit 2009 kur në Asamblenë e Përgjithshme të FNK, pa asnjë votë kundër, SHKÇAK pranohet në shtëpinë më të madhe të planetit të profesionit të kontabilitetit dhe auditimit.

Andaj, kur festojmë 20 vjetorin e themelimit të ShKÇAK, edhe një herë shpreh falënderimet të gjithë atyre, përfshirë këtu Zyrën Ekzekutive, anëtarët e Bordit dhe Komisioneve, anëtarësinë e gjerë dhe bashkëpunëtorët mentorë, të cilët agjendën e planifikuar që të realizohet deri në vitin 2012, e përmbushen në afatin rekord që rezultoi me anëtarësimin në FNK në vitin 2009.”


Naim Avdiu
Koordinator i Qendrës për hulumtim, përkrahje dhe avokim

“Epoka e re e globalizimit kërkon që të rishqyrtojmë rolet, përgjegjësitë dhe vlerat tona profesionale. Kualiteti po dikton një filozofi të re shërbimi dinamik. Edukimi profesional do të mbetet thelbësor përballë tendencave globale ekonomike dhe konkurrencës së tregut të lirë. Aftësitë e kontabilistëve dhe auditorëve duhet të zgjerohen për të përfshirë të veçoritë dhe funksionet kryesore të risive teknologjike. Ne duhet të zhvillohemi sipas dinamikës së ndryshimeve në botë. Jam i lumtur që jam pjesë e ShKÇAK dhe të kontribuoj fuqishëm të avancojmë profesionin tonë konform zhvillimeve globale.”

Blerim Pushkolli
Zëvendës Drejtor







PAJTUESHMËRIA E SHKÇAK ME KËRKESAT E LIGJIT PËR KONTABILITET RAPORTIM FINANCIAR DHE AUDITIM

Në vitin 2014 Këshilli Kosovar për Raportim Financiar (KKRF) filloi zbatimin e kërkesave që dalin nga ligji, e të cilat i referohen kërkesave të mbikëqyrjes së Shoqatave. ShKÇAK edhe njëherë demonstroi profesionalizimin e saj në përmbushjen e ligjit dhe kërkesave ndërkombëtare që dalin nga Deklaratat e Obligimeve të Anëtarësisë (DOA) të lëshuara nga Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve (FNK).

Si rezultat i kësaj dhe falë reputacionit të mirë global të ShKÇAK, Instituti Amerikan i Auditorëve të Çertifikuar Publik (AICPA) merr përsipër kryerjen e mbikëqyrjes së zbatimit të standardeve dhe procedurave.



z. Jim Knafo, Drejtor për Marrëdhënie ndërkombëtare, praktika publike dhe aleanca botërore në Institutin Amerikan të Auditorëve të Çertifikuar Publik (AICPA), u caktua nga ky institucion person përgjegjës për të udhëhequr mbikëqyrjen e tërë procesit në Shoqatë, me qëllim të demonstrimit se ShKÇAK ka vepruar konform kërkesave ligjore dhe në përputhje me Deklaratat e Obligimeve të Anëtarësisë (DOA) të FNK-së.

“Asociacioni ynë është krenar që ka punuar me ShKÇAK gjatë njëzet viteve të fundit dhe ka qenë privilegj të shikoj se si SHKÇAK është rritur për t’u bërë një lider integral në profesionin e kontabilitetit dhe auditimit në Kosovë. SHKÇAK ka punuar me zell për ndërtimin e profesionit që nga fillimi i tij në vitin 2001; kam besim se SHKÇAK do të vazhdojë të jetë një forcë për të mirën në profesion edhe për shumë vite në vijim.”

Jim Knafo,
Drejtor, Global Alliances — Asociacioni i Kontabilitetit
Publik | AICPA | CIMA

“Ne besojmë se informacionet e përmbledhura në këtë raport të cilat janë ofruar nga ShKÇAK-u, FNK-ja, NBA-ja, BB-ja, dhe ZAP-i, do të jenë të mjaftueshme për të marrë një vendim për sa i takon asaj se ShKÇAK ka vepruar në përputhje me kërkesat ligjore të KKRF.

“Dëshirojmë të përgëzojmë ShKÇAK-në për progresin e rëndësishëm që ka shënuar që nga themelimi i saj, vetëm 13 vjet më parë në vitin 2001 dhe ta urojmë për arritjet dhe sukseset e shumta gjatë kësaj kohe. Ne besojmë se, pas shqyrtimit të këtij raporti nga ana juaj, ju do të vazhdoni të njihni ShKÇAK-un sipas dispozitave të Ligjit dhe Udhëzimit Administrativ.”

Znj. Susan S. Coffey

CPA, CGMA, Zëvendës President, Praktikat Publike & Aleancat Globale

Pjesë nga Raporti i Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (FNK)

“Ne besojmë se ShKÇAK-ja kontribuon ndaj reformave rregullatore në një mënyrë të tillë që rrit efikasitetin e përgjithshëm të sistemit rregullativ nëpërmjet rritjes së dedikimit për promovimin dhe vënien në zbatim të praktikave profesionale të cilësisë së lartë ashtu siç edhe komunikohen në DOA-të e FNK-së. FNK do të vazhdojë të monitorojë nga afër progresin e ShKÇAK-së për sa i takon zhvillimit të profesionit kontabël në Kosovë dhe kundrejt ofrimit të kontributeve për themelimin e një kornize të raportimit financiar e cila është në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira.”

Znj. Sylvia Tsen

Drejtoreshë e Lartë për Kualitet dhe Marrëdhënie me Anëtarët në FNK



Pjesë nga Raporti i Qendrës për Reformimin e Raportimit Financiar – Banka Botërore (CFRR)

“ShKÇAK-ja është një anëtare aktive kontribuuese e programit Rruga për në Evropë: Programi i Reformave Kontabël dhe Forcimit Institucional (REPARIS), implementimi i të cilit nga ana e CFRR-së nisi në vitin 2008. Përfaqësuesit e këtij programi marrin pjesë në të gjitha aktivitetet përkatëse në shkallë rajonale, përfshirë Praktikat e Komunitetit të Edukuesve, Trajnimet e Trajnuesve për Auditim, Seminaret e Zyrtarëve të Lartë, etj. Gjatë këtyre ngjarjeve, shpesh kemi mësuar nga eksperiencia e ShKÇAK-së, për sa i takon ofrimit të trajnimeve, edukimit, licencimit, dhe bashkëpunimit ndërkombëtar.”

Z. Henri Fortin

Kryetar në Qendrën për Reformimin e Raportimit Financiar



Pjesë nga raporti i Institutit të Ekspertëve Kontabël të Holandës (NBA)


“ShKÇAK-jaka vënë në zbatim Standardet Ndërkombëtare të Edukimit të BSNEK (DOA 2), ndërsa ka marrë pjesë aktive në përkthimin e Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) (DOA 7), të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) (DOA 3), dhe deklarimeve të tjera të BSNAS dhe Direktivave të BE-së. ShKÇAK-ja administron me rigorozitet kërkesat për hyrjen e anëtarëve të rinj në profesionin e kontabilitetit, bashkë me kërkesat për zhvillim të vazhdueshëm profesional për anëtarët ekzistues.”

Z. Berry J.G.W. Ammes,

Drejtor në Institutin e Ekspertëve Kontabël të Holandës (NBA)



Koninklijke Nederlandse
Beroepsorganisatie
van Accountants



SHKÇAK – PJESE E FEDERATAVE NDËRKOMBËTARE

ANËTARËSIMI NË FEDERATËN NDËRKOMBËTARE TË KONTABILISTËVE/FNK

Profesionaliteti, përkushtimi, komunikimi dhe bashkëpunimi i ShKÇAK me përfaqësues vendor dhe institucione ndërkombëtare që vepronin në Kosovë dhe jashtë saj kulmoi më 14 nëntor 2003 kur në mbledhjen e Këshillit të IFAC-ut të mbajtur në Singapor, ShKÇAK u bë Anëtar i Asociuar i FNK.

Sponsor për anëtarësim të SHKÇAK në FNK ishte Oda e Auditorëve të Republikës Çeke.



Ishte padyshim një ndër arritjet e para dhe më të mëdha që institucionet nga Kosova kishin arritur deri në atë kohë. Në mënyrë simbolike është parë që Kosova po shkon drejt pavarësisht dhe pranimit të saj nga institucionet me ndikim dhe përfaqësim të lartë global.

Që nga themelimi në vitin 2002, ShKÇAK ka krijuar kontakte me organizatat evropiane dhe ndërkombëtare globale që kanë një zë të fuqishëm në raportimin financiar, në auditimin dhe në gjithë profesionin.

Anëtarësimi në FNK si Anëtar i Asociuar në vitin 2003, ishte sinjali i parë publik brenda Kosovës për sa i takon faktit që ShKÇAK synonte të zhvillohej si një organizëm autonom dhe i vetëqëndrueshëm, dhe që të ishte pjesë e komunitetit ndërkombëtar të kontabilistëve dhe auditorëve profesionistë.

Në fund të vitit 2008 Këshilli i ShKÇAK-së filloi zyrtarisht procesin e aplikimit për anëtarësi të plotë të ShKÇAK-së në FNK.

Ky vendim erdhi pas përfundimit nga ana e Zyrës Ekzekutive dhe Këshillit të një programi thelbësor të reformave duke krijuar një strukturë të qëndrueshme të qeverisjes, ndërtimit të kapaciteteve të ShKÇAK-së, zhvillimit të shërbimeve, të organizimit dhe lansimit të programit të ri të edukimit profesional. Gjatë muajve të parë të vitit 2009, Zyra Ekzekutive punoi për përpilimin e informacioneve të aplikimit për FNK.

Royal NIVRA, Instituti Holandez i Kontabilistëve të Autorizuar ishte sponsor i SHKÇAK-në për anëtarësimin e plotë në FNK në vitin 2009.



Njëri prej momenteve më të rëndësishme që e shënojnë dekadën e parë të historisë së profesionit të kontabilitetit dhe auditimit, ishte data 17 nëntor 2009 kur ndodhi dorëzimi i çertifikatës së Anëtarësisë së Plotë në FNK – kryetarit të Këshillit të ShKÇAK-së nga ana e Presidentit të FNK-së, pas vendimit unanim të Asamblesë së Përgjithshme të FNK-së për ta pranuar ShKÇAK-në si anëtare të saj me të drejta të plota.

“Anëtarësia e plotë në FNK nuk është fundi i këtij udhëtimi – është vetëm fillimi. Ne kemi arritur synimin tonë të pjesëmarrjes në profesionin e kontabilitetit, si të barabartë dhe tani do të përballohemi me sfidat e ardhshme të ndërtimit të profesionit brenda dhe jashtë Kosovës.”

Ardiana Bunjaku, 2009
Drejtoreshë Ekzekutive



“Së fundi, lidhshipi i mirë i një shoqate profesionale të kontabilitetit dhe auditimit bën miq ndërkombëtar. ShKÇAK ka bërë gjërat e duhura, në kohën e duhur dhe me një pasion që miqtë ndërkombëtarë e respektojnë dhe e shpërblejnë. Urime realizimin e pothuajse në një kohë rekord të anëtarësimit të plotë në FNK.”

R. William Phelps, 2009
Zëvendës president ekzekutiv, CARANA Corporation

“Si kryetar i ShKÇAK, mbaja komunikime të vazhdueshme me të gjithë anëtarët dhe u pajtuam që në Statutin e Shoqatës të vendosen, e më pas të fillohet të zbatohen kërkesat e Deklaratave të Obligueshme të Anëtarësimit dhe Standardet e Kontrollit të Cilësisë, standarde të larta dhe obliguese profesionale, por të vetëdijesuar se shërbenin për qëllime madhore të interesit publik. Me këtë anëtarët e ShKÇAK edhe pse në shtetin ende në tranzicion, u rreshtuan krahas vendeve të zhvilluara që e kurorëzoi ShKÇAK-në me anëtarësim me të drejta të plota në FNK. Kjo ishte kurorë për të gjithë që punuan në mënyrë të palodhshme për përmbushjen e qëllimeve të parashtruara, ndërsa mua më buzëqeshi fati të përfaqësoj ShKÇAK në këtë ngjarje të rëndësishme dhe të përjetoj e mocione të papërshkrueshme.”

Naim Avdiu, Kryetar i Këshillit
2007-2010



Në 10 Dhjetor 2009 Shkëlqesia e tij Presidenti i Republikës së Kosovës, Ministri i Ekonomisë dhe Financave, Drejtori i Misionit të USAID, Drejtori i Zyrës së Bankës Botërore në Kosovë, këshilltarët e tanishëm dhe të mëparshëm të Zyrës Ndërlidhëse të Komisionit Evropian në Kosovë (ECLO), bashkë me institucionet dhe organizatat afariste të Kosovës u mbledhën bashkë me familjen e ShKÇAK për të na uruar për arritjen e anëtarësisë së plotë në FNK. Tema e kësaj ngjarje ishte **“la dolëm së bashku”**.



“Kriza financiare na tregon të gjithë neve se problemet ekonomike nuk njohin kufi, nuk janë të një vendi, nuk njohin ngjyrë profesion apo racë. Problemet ekonomike cenojnë jetën e të gjithë qytetarëve pavarësisht bindjet e tyre politike, prandaj konsideroj se ShKÇAK ka tejkaluar këtë formulë të çfarëdo ngjyrimi përmes sukseseve të cilat sot ne po i festojmë bashkë. Jam ndier shumë krenar kur Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës e arriti anëtarësimin në Federatën Ndërkombëtare të Kontabilistëve muajin e kaluar. Kjo tregon dedikimin e fortë të këtij institucioni dhe të njerëzve që kanë punuar dhe udhëhequr me të”

Ahmet Shala, 2009
Ministër për ekonomi dhe financa, 2008-2010

“Kjo është një arritje e rëndësishme, pasi që ShKÇAK është njëra ndër pak shoqata profesionale të kontabilitetit dhe auditimit në Ballkan që kanë përmbyshur standardet rigoroze që ka arritur njohjen nga FNK. USAID është krenare që ka mbështetur ShKÇAK që nga themelimi i saj. Fakti që ShKÇAK ka përmbyshur kriteret e rrepta të anëtarësimit në FNK tregon qëndrueshmërinë financiare dhe operacionale të SHKÇAK si një organizatë.”

Patricia Rader, 2009
Drejtoreshë e misionit të USAID/Kosovë



“Urime për ne të gjithë! Unë pres me padurim festimin e ngjarjeve të tjera të reja, për të cilat mund të përdorim të njëjtën temë, ndërsa festojmë sukseset tona në të ardhmen.”

Fatmir Sejdiu,
President i Republikës së Kosovës 2006-2010



"Gjërat që janë arritur, e bëjnë ShKÇAK një nga shoqatat e pakta profesionale në rajon të cilat kanë përmbushur synime kaq të rëndësishme, për sa i takon ofrimin të shërbimeve cilësore dhe integritimit ndërkombëtar. Siç edhe mund të shihet, ka përsëri shumë e shumë sfida me të cilat do të duhet të përballohemi, por kam besim të plotë se ShKÇAK do të ofrojë kontributin e saj tepër të çmuar (ashtu siç ka bërë gjithmonë) për sa i takon ecjes përpara për të vënë në zbatim një kornizë moderne të raportimit financiar, për të arritur kështu integritimin gradual e të plotë në Bashkimin Evropian."


Ranjit Nayak, 2009
Përfaqësues i Bankës Botërore në Kosovë,
2007-2011

"Shoqatës iu kam bashkëngjitur që nga themelimi i saj. Si anëtar i Shoqatës, i Këshillit në disa mandate dhe kryetar i Këshillit, duke përfaqësuar Shoqatën, kam parë respektin e partnerëve, rajonal ashtu edhe ndërkombëtar, fuqinë e anëtarëve të saj dhe të arriturat e saj. Kam pasur mundësinë dhe nderin që të prezantoj të arriturat e Shoqatës te institucioni më i lartë i vendit, siç ishte Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës. Duke vlerësuar të arriturat e Shoqatës, dy presidentë të Republikës së Kosovës kanë marrë pjesë në dy konferenca të organizuara nga Shoqata në vitin 2009 dhe 2012.

Andaj, Shoqata mbetet synim i çdo profesionisti, aty ku ka dije, disiplinë dhe zhvillim."

Fahri Breznica,
Kryetar i Këshillit
2012 -2014





ANËTARËSIMI NË FEDERATËN E EKSPERTËVE TE KONTABILITETIT TË MESDHEUT/ FÉDÉRATION DES EXPERTS COMPTABLES MÉDITERRANÉENS (FCM)

Gjatë takimit të Federatës së Ekspertëve të Kontabilitetit të Mesdheut i mbajtur në Dhjetor 2005 në Stamboll/Turqi, ShKÇAK kishte aplikuar për anëtarësim në Federatën e Kontabilistëve të Mesdheut – FCM.


Aplikimi i ShKÇAK u aprovua nga ana e anëtarëve të Këshillit, dhe zyrtarisht SHKÇAK u pranua si anëtare me të drejta të plota më 16 Nëntor 2006.



Që nga ajo kohë SHKÇAK merr pjesë aktive në të gjitha aktivitetet e FCM duke kontribuar jo vetëm në aspektin profesional por edhe në promovimin e Kosovës. Pjesëmarrja aktive e përfaqësuesve të Shoqatës në takime është me qëllim të bashkëpunimit dhe zhvillimit të mëtutjeshëm të profesionit të kontabilitetit dhe auditimit në vendet e regjionit mesdhetar duke marrë parasysh se kjo organizatë ka anëtarë nga BE, Azia Perëndimore dhe Afrika Veriore.

Në vitin 2013 Znj. Bunjaku u zgjodh anëtare e bordit Ekzekutiv të kësaj Federate për dy mandate, respektivisht deri në vitin 2017.





ANËTARËSIMI NË FEDERATËN EVROPIANE TË KONTABILISTËVE DHE AUDITORËVE PËR NDËRMARRJE TË VOGLA DHE TË MESME/EFAA

Roli i Shoqatës në zhvillimin e qëndrueshëm të profesionit gjatë vitit 2016 u fuqizua edhe më shumë me anëtarësimin në Federatën Evropiane të Kontabilistëve dhe Auditorëve për ndërmarrje të vogla dhe të mesme/European Federation of Accountants for SMEs (EFAA).

Përmes këtij anëtarësimi, profesionistët vendorë/anëtarë të Shoqatës bëhen pjesë e kësaj organizate evropiane, e cila ka nën ombrellën e vet më shumë se 320.000 anëtarë profesionistë të kontabilitetit, auditimit dhe këshilltarë tatimorë, që vijnë nga shtetet e Evropës.



ShKÇAK ka luajtur një rol aktiv në iniciativat e Federatës Evropiane të Kontabilistëve dhe Auditorëve për NVM (EFAA) duke kontribuar në proceset e ligjvënies në Komisionin Evropian. Nga viti 2018, z. Nazmi Pllana dhe z. Lulzim Zeka përfaqësojnë ShKÇAK në Grupet e Ekspertëve të Kontabilitetit dhe Grupet të Ekspertëve të Auditimit në EFAA.

Grupet e ekspertëve të EFAA luajnë një rol aktiv dhe të rëndësishëm në përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme pranë politik-bërësve dhe akterëve tjerë relevant.



ShKÇAK mbetet e vetmja shoqatë nga Kosova e cila është anëtare e Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve dhe Auditorëve (FNK), Federatës Evropiane të Kontabilistëve dhe Auditorëve për NVM (EFAA) dhe Federatës Mesdhetare të Kontabilistëve (FCM).

Përfaqësimet ndërkombëtare

Pas anëtarësimit në organizatat globale në fushën e kontabilitetit dhe auditimit, ShKÇAK u bë pjesë e pandashme e organizimeve të ndryshme ndërkombëtare siç janë takimet vjetore, kuvende, kongrese, seminare, punëtori dhe tryeza pune. Përfaqësues të ShKÇAK kontribuan si pjesë e komisioneve të ndryshme, anëtar të bordeve si dhe nëpërmes prezantimeve të ndryshme ku u pasqyruan aktivitetet dhe sukseset e Shoqatës ndër vite.

Nga përfaqësimi global në kongrese botërore vlen të veçohen kongreset botërore të kontabilistëve të organizuara nga FNK dhe vendet nikoqire çdo 4 vite:

Kongresi Botëror të Kontabilistëve në Malajzi në vitin 2010, në të cilin ShKÇAK kishte përfaqësuesit e saj, kontributi i ShKÇAK lidhur me zhvillimin e profesionit të ri në ekonomitë e reja në Ballkanin Perëndimor u vlerësua duke zgjedhur Drejtoreshën Ekzekutive të ShKÇAK-së, Znj. Ardiana Bunjaku, në Komisionin për Zhvillimin e Organizatave Profesionale të Kontabilitetit të FNK (PAODC).



Kongresi Botëror i Kontabilistëve/ Auditorëve 2014 (WCOA) i organizuar nga FNK dhe Këshilli Kombëtar Italian i Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve (CNDCEC) u mbajtë në Romë gjatë nëntorit 2014. Në fokus të Kongresit Botëror ishte tema "Vizioni për 2020: Mësimi nga e kaluara, ndërtimi i së ardhmes." Drejtoresha Ekzekutive e ShKÇAK-së prezantoi temën "Perspektivat e drejtorëve ekzekutiv të organizatave anëtare të FNK". Si dhe në kuadër të sesioneve të këtij Kongresi ishte në grupin e panelistëve për të diskutuar rreth "Kontributi i profesionit të Kontabilitetit dhe Auditimit në Menaxhimin e Financave Publike moderne".



- Kongresi Botëror i Kontabilistëve (WCOA 2018) u mbajt në Sidnej, Australi. Tema kryesore gjatë Kongresit ishte: "Sfidat globale. Liderët global" dhe kishte për qëllim t'i informonte pjesëmarrësit mbi të ardhmen e profesionit dhe ndryshimet që do vinin në të ardhmen. Gjatë kësaj ngjarje, Znj. Bunjaku zgjedhet në Panelin këshillues për pajtueshmëri të FNK, për mandat dy vjeçar 2019-2021.



Përfaqësuesit e ShKÇAK ishin pjesë e paneleve të organizuara nga FNK. Vlen të përmendet prezantimi në Mbledhjen e Asamblesë së FNK-së në Bruksel, ku Znj. Edona Perjuci Udhëheqëse e Departamentit të Edukimit dhe Standardeve Profesionale dhe Z. Arbër Hoti Udhëheqës i Departamentit të Sigurimit të Cilësisë prezantuan "Rrugëtimin e zhvillimit të ShKÇAK-s ndër vite", si një shembull i mirë i zhvillimit të një shoqate profesionale në vendet në zhvillim.



"Ju falënderoj nga zemra për prezantimin e ekipit tuaj para Këshillit të FNK-së. Prezantimi u vlerësua lart nga anëtarët tanë. Me kënaqësi presim të vazhdojmë të mësojmë nga ju dhe të punojmë me ju. Ekipi dhe puna e juaj janë me të vërtetë të mrekullueshëm"

Alta Prinsloo,
Drejtoreshë e Departamentit të Cilësisë dhe Zhvillimit të FNK-së.

"FNK ka shumë pika të forta. Por ajo që FNK synon të bëjë është e mundur vetëm me anëtarët tanë. Ata së bashku realizojnë transformimet globale duke shpërndarë burimet e tyre në shtrirjen gjeografike . Për 20 vjet të shërbim të jashtëzakonshëm, partneritet të vazhdueshëm dhe përkushtim ndaj interesit publik, jo vetëm në Kosovë por me të vërtetë në mbarë botën, dua të them: faleminderit! Ka qenë privilegj të punoj së bashku me SHKÇAK që kur organizata juaj iu bashkua FNK-së në 2003. Pavarësisht sfidave të vazhdueshme, shpresoj që të gjithë anëtarët e SHKÇAK festoni këtë përvjetor me krenarinë dhe mirënjohjen që meritojnë arritjet tuaja."

Joseph Bryson
Drejtor, Cilësi & Zhvillim, FNK




Përfaqësues të SHKÇAK me angazhimin e tyre u bënë pjesë e strukturave të FNK. Në vitin 2011 Znj. Ardiana Bunjaku nominohet dhe zgjedhet Anëtare e Komisionit për zhvillimin e organizatave profesionale për dy mandate 2011-2016 duke vazhduar më pas edhe si këshilltare në këtë komision deri në vitin 2020.

Në vitin 2019, Znj. Bunjaku zgjedhet për mandat 2 vjeçar në Panelin Këshillues për Pajtueshmëri në FNK.

"Anëtare prej ditëve të para të themelimit të SHKÇAK, jam rritur profesionalisht krahas shoqatës dhe me admirim shiqoja se si ajo po shndërrohet në forcë të zhvillimit të profesionit dhe ngjitej pa ndalë rrugës që të mbrijë të jetë përkrah organizatave të themeluara edhe një shekull më parë në botë.

Vitet 2018-2020 si kryetare e parë grua e Këshillit të SHKÇAK ishin të mbushura me punë por edhe krenari se kisha rastin që nga afër të shihja respektin që gëzojmë si në vend ashtu edhe në qarqet ndërkombëtare të profesionit. Besoj dhe uroj që të vazhdojmë me të njëjtën vendosmëri të punojmë dhe kontribuojmë në zhvillimin e shoqërisë sonë edhe shumë 20 vjetor të tjerë."

Afërdita (Çarkaxhiu) Gashi,
Kryetare e Këshillit 2018-2020



ShKÇAK luan një rol të rëndësishëm në ngritje të kapaciteteve në institucionet publike të Republikës së Kosovës, bashkëpunimi i ngushtë në mes të institucioneve për zhvillim profesional është marr si shembull në konferenca, udhëzues dhe artikuj të ndryshëm global.

Gjatë vitit 2019, FNK në partneritet me INTOSAI (International Organization of Supreme Audit Institutions), dhe donatorët global organizuan konferencën “Përgatitja për profesionin për të ardhmen - Zhvillimi i Kapaciteteve të Kontabilitetit dhe Auditimit në ekonomitë në zhvillim” e cila është mbajtur në Malajzi.




Panelistët nga Kosova:

Drejtoresha Ekzekutive e ShKÇAK – Znj. Ardiana Bunjaku
Auditori i Përgjithshëm i Kosovës – Z. Besnik Osmani
Zëvendës-Auditori i Përgjithshëm – Z. Ilir Salihu
Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit – Z. Ahmet Ismaili

Drejtoresha Ekzekutive e ShKÇAK – Znj. Ardiana Bunjaku gjatë kësaj konference ishte paneliste edhe në panelin e diskutimit “Parimet dhe praktikat e një Drejtori Ekzekutiv efektiv të Organizatave Profesionale të Kontabilitetit dhe Auditimit”.





MBËSHTETJA E VAZHDUESHME PËR SEKTORIN PUBLIK DREJT RITJES SË TRANSPARENCËS, LLOGARIDHËNIES DHE IMPLEMENTIMIT TË STANDARDEVE TË CILËSISË SË LARTË

ShKÇAK qysh nga themelimi ka qenë shumë aktive në profesionin e kontabilitetit dhe auditimit në vend duke organizuar module specifike të trajnimeve dhe certifikimeve, konferenca, seminare dhe tryeza pune për anëtarët e saj, zyrtarë publik dhe palët tjera me interes në fuqizimin e menaxhimit të financave publike dhe raportimin financiar përmes zhvillimit të kapaciteteve efektive në nivel institucional. ShKÇAK ka kontribuar gjithashtu në identifikimin e ndryshimeve të nevojshme ligjore si dhe në implementimin e kërkesave të reja ligjore.

Bashkëpunimi me institucionet vendore relevante si Ministrinë e Financave, Këshillin Kosovar për Raportim Financiar, Bankën Qendrore, Drejtorinë e Thesarit, Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, Zyrën Kombëtare të Auditimit, Administratën Tatimore të Kosovës, Agjensionin Kosovar të Mirëbesimit, dhe me institucionet ndërkombëtare; Bankën Botërore, USAID, Zyrën e Unionit Evropian, GIZ, UNDP, Zyra Zvicerane për Bashkëpunim, etj, që operojnë përmes zyrave të tyre në Kosovë ishte prioritet i lartë për Shoqatën.



ShKÇAK duke qenë në bashkëpunim të vazhdueshëm me Këshillin Kosovar për Raportim Financiar (KKRF) ka adresuar shumë çështje nepërmes përfaqësuesëve të Shoqatës që ndërlidhen me avancimin e profesionit të kontabilitetit dhe auditimit, ku fokus kryesor i bashkëpunimit ishte zbatimi i SNAve, SNRF-ve, sfidat e implementimit, mundësitë dhe rekomandimet për ndryshimet e nevojshme të ligjit për kontabilitet dhe raportim financiar.

Bashkëpunimi në mes SHKÇAK dhe Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA) të Kosovës, një shembull në sferën ndërkombëtare për fushën e raportimit financiar në sektorin publik

Në vazhdimësi të krijimit të institucioneve publike dhe shtetërore në Kosovë, gjatë nëntorit të vitit 2003 u emërua Auditori i parë i Përgjithshëm të Kosovës, Znj. Inga-Britt Ahlenius nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP). Duke u bazuar në kualitetin e lartë të shërbimeve dhe të programit certifikues që ofronte SHKÇAK, Zyra e Auditorit Gjeneral duke qenë njëri prej institucioneve më të rëndësishme në vend e ka parë si domosdoshmëri certifikimin të Auditorëve të zyrës së Auditorit Gjeneral pranë SHKÇAK-së, me qëllim të zhvillimit të kapaciteteve profesionale dhe funksionalizim të zyrës. Trajnimet e para me filluan më 15 dhjetor 2003.

Trajnimet e niveleve të ndryshme që vazhdojnë deri në ditët e sotshme paraqesin një bashkëpunim të ndërsjellë profesional në mes SHKÇAK dhe Zyrës Kombëtare të Auditimit.



SHKÇAK dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm pas emërimit të Z. Lage Olofsson si Auditor i Përgjithshëm i Kosovës kanë krijuar programin unik dhe të parë në rajon dhe më gjerë të certifikimit për auditorët e sektorit publik të bazuara në IPSAS, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI) të krijuara nga Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI).

Programi u zbatua si pjesë e marrëveshjes ndërmjet SHKÇAK dhe Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm i cili është nënshkruar në vitin 2013, për të zhvilluar skemën e re të certifikimit në sektorin publik dhe privat, duke synuar ngritjen profesionale të auditorëve dhe rritjen e nivelit dhe cilësisë së menaxhimit të financave publike, raportimit financiar dhe auditimit.

Gjatë vitit 2015, si rezultat i bashkëpunimit të vazhdueshëm në mes të ShKÇAK dhe Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm , i gjithë stafi i auditimit të këtij institucioni kanë ndjekur dhe përfunduar çertifikimin në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI) të vendosura nga Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI), ku një rol këshillëdhënës ka edhe Zyra e Auditorit Suprem të Suedisë në kuadër të bashkëpunimit me Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm.



Zhvillimet e fundit globale në fushën e financave dhe kontabilitetit kanë nxjerrë në pah nevojën për ngritjen e kapaciteteve profesionale në fushën e financave dhe kontabilitetit është parë si domosdoshmëri për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në sektorin publik.

ShKÇAK është përkrahëse e punës së Zyrës Kombëtare të Auditimit e cila promovon drejtpërdrejt llogaridhënien dhe ofron një bazë të qëndrueshme të sektorit publik financiar.



Bashkëpunimi në mes SHKÇAK dhe Administratës Tatimore të Kosovës

SHKÇAK gjatë tërë kohës ka vazhduar bashkëpunimin e ngushtë me Administratën Tatimore të Kosovës, duke organizuar dhe realizuar seminare, konferenca dhe tryeza të punës, që kanë të bëjnë me shpjegime të detajuara për ligjet e miratuara tatimore si dhe u organizuan edhe EVP relevante mbi përforcimin dhe azhurnimin e njohurive të kontabilistëve dhe auditorëve të certifikuar në zbatimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) dhe Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit.




SHKÇAK që nga fillimi kishte një bashkëpunim me ATK jo vetëm në fushën e trajnimeve të stafit të ATK-së por ishte mjaft kontribuuese në draftimet ligjore dhe propozimet për ndryshime ligjore.

Një ndër bashkëpunimet e rëndësishme me qëllim të fuqizimit të kapaciteteve profesionale në ATK ishte Programi Ekspert Tatimor, për inspektorët nga njësia e tatimpaguesve të mëdhenj dhe njësia e tatimpaguesve të mesëm të ATK. Ky program është realizuar me iniciativë të ShKÇAK dhe me bashkëfinancim nga Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ) dhe Ambasada Britanike në Kosovë.

ShKÇAK ka qenë dhe do të mbetet partner i ATK-së në ngritjen e kapaciteteve profesionale brenda këtij institucioni me qëllim të përmirësimit të shërbimeve për tatimpagues dhe luftimin e evazionit fiskal dhe ekonomisë joformale.





BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONE DHE DONATORË PËR NGRITJE TË KAPACITETEVE DHE ZHVILLIMIN E TRAJNIMEVE SPECIFIKE

Krizat financiare kanë orientuar drejt zhvillimit të programeve specifike të raportimit financiar në nivel global. Fokusi i SHKÇAK është në arritjen e zhvillimit të politikave të sektorit publik, marrëveshjet institucionale dhe zbatimin efektiv të tyre që të stimulojnë zhvillimin ekonomik brenda kornizës së zbatimit të kërkesave për anëtarësim në BE.

Shoqata ka zhvilluar trajnimin në fusha specifike si në menaxhimin e financave publike dhe auditimin në sektorin publik, ashtu edhe në lëmin e insolvencës, forenzikës financiare dhe tatimeve.

Gjatë vitit 2009, filloi projekti i Ndërtimit të Kapaciteteve për Falimentime i financuar nga Bashkimi Evropian dhe i menaxhuar nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian (ECLO) në bashkëpunim me SHKÇAK për zhvillimin e një trajnimi pilot për "Rimëkëmbjen e Bizneseve të Korporatave dhe Ligjit të Praktikave për Falimentimin" në të cilin morën pjesë punonjës të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.





Në vitin 2009, ShKÇAK dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave nënshkruan një memorandum të mirëkuptimit për të krijuar Programin e Trajnimeve për Menaxhimin e Financave Publike i cili ishte program për zyrtarë të financave në sektorin publik. Qëllimi kryesor i këtij programi ishte trajnimi dhe pajisja e zyrtarëve të financave në sektorin publik me aftësitë e domosdoshme për të përmirësuar menaxhimin e financave dhe raportimin financiar në sektorin publik të Republikës së Kosovës.

Gjatë kësaj periudhe së bashku me këshilltarët e projektit të BE “Ndërtimi i kapaciteteve të insolvencës në Kosovë” është punuar drejt finalizimit të librave në Ligjet dhe praktikën e falimentimeve dhe Rimëkëmbja e biznesit të korporatave.



Shoqata ka bashkëpunim të vazhdueshëm me Njësinë e inteligjencës Financiare (NJIFK) me qëllim të edukimit dhe vetëdijesimit të anëtarëve të saj dhe publikut të gjerë, në fushën e zbatimit të Ligjit për Parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit.



ShKÇAK ka krijuar një program të specializuar për ekspertët e forenzikës financiare. Qëllimi i këtij programi është të ndihmojë në luftën kundër korrupsionit dhe të hapë rrugën për zhvillimin ekonomik duke ndërtuar kapacitete hetimore në fushën e krimeve ekonomike. Programi “Ekspert i Licencuar i Forenzikës Financiare” ishte zhvilluar me mbështetjen e Programit Zhvillimor të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNDP Kosovo) dhe financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim (Swiss Cooperation Office) dhe Programi DANIDA i Qeverisë së Danimarkës në vitin 2017. Në këtë program u trajnuan dhe certifikuan 50 zyrtarë nga institucionet qeveritare siç janë Prokuroria, Policia e Kosovës, Dogana, Njësia e Inteligjencës Financiare, Agjencinë Kundër Korrupsionit dhe gazetarët hulumtues të BIRN-it.



“ShKÇAK ka kryer një punë të jashtëzakonshme në krijimin e programit të parë të akredituar të forenzikës financiare në Kosovë. Profesionalizmi i tyre dhe vëmendja ndaj detajeve ka rezultuar në një program sfidues i cili mëson kandidatët të zgjerojnë punën e tyre në investigimin e aktiviteteve kriminale përmes analizave të regjistrave financiar. Autoritetet kosovare kundër korrupsionit tani kanë brenda tyre ekspertizën e duhur dhe aftësinë për të zbuluar dhe kthyer asetet e vjedhura, falë punës së ShKÇAK. Mirëpresim bashkëpunimet e ardhshme mes UNDP dhe ShKÇAK.”

**Mato Meyer,
Menaxher i Projektit, UNDP**

Vlerësimi i lartë për suksesin e Shoqatës ndër vite ka reflektuar suksesin jo vetëm të studentëve dhe anëtarëve të saj por edhe ka qenë një promovim i Kosovës në të gjitha anët e botës.



Organizimi i Konferencës së parë ndërkombëtare për Raportim Financiar në Kosovë është bërë si pjesë e festimit të 10 vjetorit të krijimit të SHKÇAK.

Kjo konferencë me mbështetje të Bankës Botërore ka pasur për synim të shqyrtoj sfidat dhe mundësitë me të cilat ballafaqohen ekonomitë në tranzicion në fuqizimin e menaxhimit të financave publike dhe raportimin financiar të korporatave, përmes zhvillimit të kapaciteteve efektive në nivel kombëtar.



Në konferencë morë pjesë nga institucione vendore dhe ndërkombëtare duke përfshirë këtu FNK, Banka Botërore, CIPFA, Banka Qendrore e Kosovës, Oda Ekonomike Amerikane e Kosovës, Oda Ekonomike e Kosovës, Zyra e Auditorit Gjeneral, si dhe përfaqësues të Shoqatave të vendeve në rajon dhe më gjerë si nga Shqipëria, Kroacia, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia, Bosnja - Hercegovina dhe Moldavia.



Një nder i veçantë ishte prania dhe hapja e konferencës nga presidentja e Republikës së Kosovës, Znj. Atifete Jahjaga.

ShKÇAK organizoi seminar regional në bashkëpunim me Fondacionin SNRF, organizim i parë i këtij lloji për vendet e Evropës Juglindore.

Ky seminar ka arritur të tërheq vëmendjen e rreth 200 profesionistëve vendorë, standardvënësve ndërkombëtarë, përfaqësuesve nga Ministria e Financave, Banka Botërore, USAID, Universiteteve, dhe Shoqatave Profesionale të rajonit. Seminari kishte për qëllim t'i pajisë pjesëmarrësit me njohuritë lidhur me ndryshimet dhe ngjashmëritë ndërmjet SNRF-ve të plota dhe SNRF-së për NVM-të.




Aktiviteti kryesor për ta shënuar përvjetorin e 15-të - jubilar ishte organizimi i Forumit “Specializimi profesional-Domosdoshmëri për zhvillimin ekonomik”, me qëllim të sensibilizimit të rëndësisë së zhvillimit profesional dhe promovimit të specializimit profesional të individëve.

Kjo ngjarje e cila për herë të parë u organizua në një format të tillë në Kosovë, shënoi fillimin e një ere të re që ka të bëjë me sensibilizimin e politik bërësve, Institucioneve arsimore, bizneseve dhe të gjithë akterëve relevantë, për rëndësinë e ngritjes dhe zhvillimit të profesionistëve në profile të ndryshme.



Në shënim të 10 vjetorit të Pavarësisë së Republikës së Kosovës, ShKÇAK organizoi konferencën “Zhvillimi i profesionit të kontabilitetit dhe auditimit në dekadën e parë të Pavarësisë” e cila u mbajt në Prishtinë. Konferenca i bashkoi pjesëmarrësit kyç për të diskutuar mbi zhvillimet në sferën e profesionit gjatë dekadës së parë të pavarësisë dhe sfidat e përballura në zbatimin e kërkesave për raportim financiar dhe auditim efektiv, si bazë për krijimin e një mjedisi për tërheqjen dhe ruajtjen e investimeve të huaja dhe vendore si dhe mbi rëndësinë e kontributit të profesionistëve në avancimin e raportimit financiar dhe auditimit në Kosovë.






BASHKËPUNIMI ME ODAT EKONOMIKE

ShKÇAK duke qenë anëtare në odat ekonomike të cilat veprojnë në Kosovë ka qenë mjaft bashkëpunuese dhe aktive. Shoqata ka organizuar dhe ka marrë pjesë në konferenca, takime, seminare dhe tryeza të punës me odat duke kontribuar jo vetëm në avokimin e rëndësisë së raportimit financiar, ndryshimeve të nevojshme në legjislacion por duke dhënë kontributin edhe në çështje të tjera të rëndësishme në aspektin tatimor dhe biznesor.





BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET ARSIMORE

ShKÇAK nga themelimi i saj si pjesë të strategjisë gjithmonë i ka dhënë rëndësi bashkëpunimit me Institucionet e Arsimit të Lartë në mënyrë që gjeneratat e reja qysh në hapat e parë të përcaktimit për karrierën e tyre të arrijnë njohuri me standardet ndërkombëtare të profesionit.

Bashkëpunimi i shkëlqyeshëm i ShKÇAK dhe programeve të Komisioni Evropian dhe USAID- it kanë siguruar mbështetjen për krijimin e një Departamenti të Kontabilitetit në Universitetin e Prishtinës. Pesë student kosovarë me financimin e USAID-it kanë përfunduar Studimet Pasuniversitare në Universitetin e Arizonës në vitin 2009.



Shoqata ka nënshkruar marrëveshjet me Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, Universiteti i Prizrenit “Ukshin Hoti”, Universiteti “Haxhi Zeka” (UHZ) në Pejë, Kolegjin UBT, Kolegjin Riinvest, me qëllim të bashkëpunimit profesional dhe implementimit të plan-programeve dhe procedurave të provimeve të SHKÇAK-së si dhe ka ndjekur politika të zgjerimit të bashkëpunimeve.



ShKÇAK dhe Cactus Education nënshkruan memorandum bashkëpunimi i cili ka për qëllim shkëmbimin e përvojave dhe praktikave më të mira në fushën e trajnimeve dhe zhvillimeve profesionale me fokus të theksuar në ngritjen e kapaciteteve drejt transformimit dhe zhvillimit digjital të profesionit.

Bashkëpunimi me Shqipërinë dhe vendet rajonale

SHKÇAK dhe Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar të Shqipërisë (IEKA) nënshkruan marrëveshjen për bashkëpunim në vitin 2012 dhe vendosën themelet për bashkëpunim afatgjatë në mes të dy shoqatave në fushën e auditimit me të vetmin synim që të bashkërendohen përpjekjet për të zhvilluar profesionin në të dy vendet tona.



SHKÇAK, FNK dhe IEKA nënshkruan marrëveshjen në vitin 2014 trepalëshe për përdorimin dhe përkthimin e standardeve ndërkombëtare, kodin e etikës, udhëzuesit dhe publikimet e tjera që janë esenciale për sa i takon mbështetjes së zhvillimit të kontabilistëve profesionistë.

“ShKÇAK është sot organizata lider e profesionit kontabël, jo vetëm në Kosovë, por edhe në rajon. Kjo arritje i dedikohet sa vizionit dhe objektivave të mirë përcaktuara, aq edhe dhe lidershit dhe largpamësisë. Krahas mbrojtjes dhe forcimit të reputacionit të anëtarëve, ShKÇAK përcaktoi si objektiv primar: kontributin për një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm të vendit dhe mbrojtjen e interesit publik. Orientimi shumëdimensional dhe organizimi i veçantë, nën drejtimin kompetent nga Znj. Bunjaku, e ka shndërruar ShKÇAK në një nyje të rëndësishme të ndërlidhjes e veprimt për shumë aktorë dhe faktorë të biznesit publik e privat dhe të qeverisë. Larmia e programeve të edukimit duke u bazuar tek nevojat e tregut, pa lënë pas dore cilësinë, dëshmojnë për një standard, i cili garanton jetëgjatësi dhe sukses, veçanërisht në mjedisin tonë të Ballkanit Perëndimor, ku mungesa e vizionit dhe keq orientimi, jo rrallë kanë prodhuar zhvillime të padëshiruara. ”

Prof. Dr. Hysen Çela,
President, Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar të
Shqipërisë (IEKA) - 2012-2019



Zhvillimi i programit të certifikimit të auditorëve për sektorin publik në SHKÇAK ka bërë jehonë jo vetëm brenda Vendlit, por edhe ka tërhequr vëmendjen e shteteve në regjion e më gjerë. Në vazhden e këtyre aktiviteteve është nënshkruar Marrëveshje të bashkëpunimit në mes të SHKÇAK dhe Kontrollit të Lartë të Shqipërisë (KLSH) në vitin 2013.

Kjo marrëveshje kishte për objektiv vendosjen e bashkëpunimit midis të dy institucioneve përmes aktiviteteve që synojnë rritjen e cilësisë së punës së stafit të KLSH-së nëpërmes ekspertizës së kualifikuar të trajnimeve për auditorët e sektorit publik nga ana e SHKÇAK-së, takimeve konsultative, tryezave të rrumbullakëta, punëtorive dhe

Gjatë vitit 2019 është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit mes SHKÇAK dhe Institutit të Kontabilistëve të Miratuar (IKM) nga Shqipëria, organizatë profesionale e kontabilitetit e cila gjatë këtij viti është pranuar si anëtare me të drejta të plota në FNK. Fokus kryesor nga arritja e marrëveshjes ishte bashkërendimi i aktiviteteve në fushën e edukimit, të promovimit të cilësisë, etikës profesionale, SNRFve, dhe shërbimeve të tjera sipas kërkesave nga FNK dhe standard-vënësit tjerë global.



"Kam kënaqësinë t'ju përcjell në emër tim dhe të anëtarëve të Institutit të Kontabilistëve të Shqipërisë (IKM), urimet më të përzemërta me rastin me rastin e 20 vjetorit të themelimit të SHKÇAK. Ne jemi të lumtur dhe shumë të vlerësuar që IKM si organizatë profesionale e Kontabilistëve të Miratuar ka një bashkëpunim të afërt dhe të dobishëm me SHKÇAK që në vitin 2002. IKM ka gjetur tek SHKÇAK që në krijimet e veta një organizatë profesionale shumë serioze dhe aktive në Kosovë por edhe në aktivitetet ndërkombëtare.

Bashkëpunimi midis dy organizatave përfshin bashkëpunim në fushat e edukimit profesional, përkthimin e materialeve të FNK, në përgatitjen e stafit kontrollues të kontrollit të cilësisë si dhe fusha të tjera si në atë të edukimit për Audituesit e brendshëm, trajnimin dhe certifikimi i anëtarëve të dy organizatave tona në fushën e legjislacionit tatimorë në Shqipëri edhe Kosovë. Me anë të këtij urimi shprehim mirënjohje për punën dhe profesionalizmin që SHKÇAK ka dëshmuar ndër vite! Urime dhe gëzuar 20 vjetorin e SHKÇAK-ut, liderit të padiskutueshëm të profesionit të audituesit dhe kontabilistëve në Kosovë!"

Prof Dr. Sotiraq Dhano,
Kryetar i këshillit të Drejtiimit, Instituti i Kontabilistëve të Shqipërisë

ShKÇAK ka filluar bashkëpunimin e saj në vitin 2016 edhe me Institutin të Auditorëve të Çertifikuar të Republikës së Maqedonisë. Ky bashkëpunim me anë të marrëveshjes së nënshkruar ka për qëllim zhvillimin dhe implementimin e planeve të veprimit në përputhshmëri me Deklaratat e Obligimeve të Anëtarësisë (DOA) për Federatën Ndërkombëtare të Kontabilistëve dhe Auditorëve (FNK/FNK), kualifikimin e vazhdueshëm profesional të anëtarëve të profesionit, kontributin bilateral në të praktikuarit e sigurimit të cilësisë, bashkëpunimin në shkëmbimin e materialeve arsimore dhe fuqizimit të rolit - të kontabilistëve dhe auditorëve si dhe të vetë profesionit në të dyja shtetet.



Bashkëpunimi rajonal u zgjerua, pasi që ShKÇAK dhe Këshilli për Mbikëqyrjen dhe Avancimin e Auditimit në Republikën e Maqedonisë (CAOARM) nënshkruan Marrëveshje e bashkëpunimit në vitin 2018 duke mundësuar krijimin e një partneriteti afatgjatë mes ShKÇAK dhe CAOARM, në mënyrë që dy organizatat të shkëmbejnë njohuritë dhe përvojat e tyre si në fushën e trajnimeve dhe edukimit të vazhdueshëm profesional ashtu edhe sigurimit të cilësisë.

SHKÇAK dhe Unioni i Odave të Kontabilistëve Publik të Çertifikuar të Turqisë (TURMOB), kanë nënshkruar dy marrëveshje në vitin 2013 për bashkëpunim që sipas vlerësimit të dy institucioneve janë tejet të rëndësishme.



SHKÇAK dhe TURMOB si anëtare me të drejta të plota të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve, përmes këtyre marrëveshjeve kanë shprehur gatishmërinë që edhe në të ardhmen ta vazhdojnë bashkëpunimin e tyre të frytshëm në zhvillimin e mëtejshëm të profesionit të kontabilitetit dhe auditimit.



SHKÇAK pjesë e programeve të QRRF

Që nga themelimi i Qendrës për Reforma të Raportimit Financiar/Center for Financial Reporting Reform (QRRF/CFRR) e Bankës Botërore me seli në Vjenë në vitin 2007, SHKÇAK ka qenë pjesë e të gjitha programeve të saj.

QRRF si pjesë e Bankës Botërore me programet dhe projektet e saj është fokusuar në përmirësimin e praktikave të raportimit financiar të korporatave dhe mbështetjen e reformës në vendet e Evropës dhe Azisë Qendrore pjesëmarrëse në QRRF.

Në kuadër të kësaj qendre, SHKÇAK ka marrë pjesë në programin REPARIS, EU REPARIS dhe PULSAR.



Gjithashtu, ShKÇAK është bërë pjesë e dy programeve të reja të QRRF-së: Programit dy vjeçar për ndërtimin e kapaciteteve rajonale për auditorët e brendshëm të sektorit publik - Trajnimi i Trajnerëve në Auditim të Brendshëm, që është organizuar në bashkëpunim të ngushtë me Komunitetin e Praktikës së Auditimit të Brendshëm (IACOP) të rrjetit të Edukimit 'peer assisted' për Menaxhimin e Shpenzimeve Publike (PEMPAL), si dhe programin për zhvillimin e kontabilitetit dhe raportimit në sektorin publik, në kuadër të programit PULSAR.

REPARIS është një program regjional që ka për qëllim të krijojë një mjedis transparent të politikave dhe një kornizë efektive institucionale për raportimin financiar të korporatave përbrenda regjionit.

REPARIS është i përqendruar në paraqitjen, implementimin dhe në fuqizimin efektiv të acquis communautaire të BE-së, që mund të kontribuojë në investimet direkte dhe investimet në portofol, të kujdeset për zhvillimet e sektorit privat dhe financiar, të përmirësojë mjedisin biznesor dhe rrethanat e investimeve, dhe të lehtësojë integrimin potencial apo harmonizimin me Bashkimin Evropian.



Në kuadër të REPARIS është edhe program REPARIS për SME, i cili është nisur në kuadër të Fondit Programatik të Mirëbesimit të Evropës 2020 - Pjesa II e ofruar nga Bashkimi Evropian me një periudhë zbatimi deri në vitin 2024.

REPARIS për SME-të synon të mbështesë: (i) përmirësimin e mëtejshëm të qasjes së SME-ve në Ballkanin lindor në shërbimet profesionale të kontabilitetit dhe menaxhimit financiar, dhe (ii) përafrimin e kornizave të raportimit financiar të korporatave të Ballkanit Lindor me direktivat dhe rregulloret përkatëse të BE-së.

Në këtë program përfaqësimi edhe në Konferencën Ministrore gjithmonë ka qenë në nivel mjaft të lartë duke përfshirë ministra të financave, përfaqësues të lartë të shteteve, autoritete të tatimeve, përfaqësues të bizneseve dhe përfaqësues të komunitetit profesional dhe akademik nga Evropa dhe Azia Qendrore.



Programi PULSAR është program në nivel rajoni dhe vendi në mbështetje të zhvillimit të kornizave të kontabilitetit dhe raportimit financiar të sektorit publik, që ofron një platformë për shkëmbimin e njohurive drejt rritjes së llogaridhënies, transparencës dhe performancës së qeverive. Objektivi i këtij programi është dhënia e mbështetjes për përmirësimin e kornizave të kontabilitetit dhe raportimit financiar të sektorit publik në trembëdhjetë vende: Armeni, Azerbajxhan, Bjellorusi, Bosnjë dhe Hercegovinë, Gjeorgji, Kosovë, Kroaci, Mal të Zi, Maqedoni, Moldavi, Serbi, Shqipëri dhe Ukrainë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe me praktikat e mira, në mënyrë që të rritet llogaridhënia, transparenca dhe performanca e qeverive.


ShKÇAK gjithashtu ka qenë pjesë e shumë punëtorive për “Trajnimin e Trajnerëve për Auditim” të QRRF/CFRR që kanë pasur fokus të veçantë zhvillimin e kapaciteteve dhe cilësive të trajnerëve, të cilët ofrojnë Edukim të Vazhdueshëm Profesional (EVP/CPD) për auditorët ligjorë dhe anëtarët tjerë të shoqatave të kontabilitetit dhe auditimit.

Përfaqësuesit e ShKÇAK-së kanë marrë pjesë rregullisht edhe në Forumet Rajonale të Organizatave Profesionale të Kontabilitetit dhe Auditimit, që ishin organizuar në bashkëpunim me Federatën Ndërkombëtare të Kontabilistëve (FNK) ku kanë marr pjesë mbi 20 vende partnere të QRRF-së për të reflektuar mbi ambientin në transformim të raportimit financiar për NVM-të në Evropë dhe Azi Qendrore.



“Që nga themelimi i Qendrës së Bankës Botërore për Reformën e Raportimit Financiar (QRRF/CFRR) në Vjenë, SHKÇAK është angazhuar në mënyrë aktive në programet e ndryshme të zhvillimit të kontabilitetit rajonal të financuara nga donatorët, të ofruara nga QRRF. Duke vepruar kështu, angazhimi i SHKÇAK ka qenë i jashtëzakonshëm në ndërtimin e partneriteteve dhe shembull praktik për të nxitur reformën rajonale. Përmes bashkëpunimeve të shumta palët e ndërlidhura dhe programeve të edukimit të cilësisë së lartë të përshtatura me nevojat e tregut, duke u përpjekur të shfrytëzojë kapacitetet e saj dhe të mbetet e hapur ndaj nevojave të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë, SHKÇAK ka qenë me të vërtetë shembull. Puna e palodhur, përkushtimi i palëkundur për t'i shërbyer interesit publik, bashkëpunimi i vazhdueshëm dhe respektimi i standardeve dhe kërkesave globale dhe të BE-së janë cilësi që i kanë shërbyer shumë mirë SHKÇAK-së drejt një organizate profesionale, autonome dhe të qëndrueshme.”

Kalina Shukarova Savovska,
Specialiste Seniore e Menaxhimit Financiar, Banka Botërore, QRRF (2013-- 2019)



BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONE NDËRKOMBËTARE

Zgjerimi i bashkëpunimit dhe njohjeve reciproke me shoqatat profesionale globale është një pikë e rëndësishme strategjike që tregon baraspeshën dhe vlerat e edukimit profesional në ShKÇAK.

Programet Çertifikuese të ShKÇAK tashmë e sa vite janë të njohura ndërkombëtarisht nga organizatat më me renome në botë. Shoqata ka njohje reciproke të thirrjeve me Shoqatën e Kontabilistëve të Çertifikuar të Britanisë së Madhe (ACCA), Shoqatën e Teknikëve të Kontabilitetit nga Britania e Madhe (AAT), Institutin e Licencuar për Financa Publike, Kontabilitet dhe Auditim (CIPFA) dhe Institutin e Kontabilistëve dhe Auditorëve të Australisë (IPA).



SHKÇAK qysh nga themelimi ka synuar të zhvillojë sistemin dhe proceset e saj me kriteret më të avancuara duke përzgjedhur si partner ACCA-në, organizata e vetme globale me bazë në 179 vende të ndryshme, e cila ka 233,000 anëtarë dhe 544,000 anëtarë të ardhshëm që mbajnë vlerat më të larta profesionale dhe etike. Një arritur e tillë e Shoqatës ishte si rezultat i implementimit të programit të ri të niveleve çertifikuese të ShKÇAK-së dhe monitorimit të matjes së njohurive përmes provimeve nga ACCA.

ShKÇAK ka nënshkruar marrëveshje për njohje reciproke edhe me Shoqatën e Kontabilistëve të Çertifikuar (AAT) me bazë në Britani të Madhe, e cila u mundëson anëtarëve të Shoqatës të ushtrojnë profesionin edhe jashtë kufijve të Kosovës. Kontabilistët dhe Auditorët e Çertifikuar të ShKÇAK-së nga viti 2017 do të mund të përfitojnë thirrje nga AAT.

Shoqata e Teknikëve të Kontabilitetit nga Britania e Madhe (AAT), që i ka në vete rreth 140 mijë anëtarë në më shumë se 90 vende në nivel global.

ShKÇAK dhe Instituti i Kontabilistëve dhe Auditorëve të Australisë (IPA) në vitin 2020 kanë nënshkruar marrëveshje të njohjes reciproke të kualifikimeve, e cila ka për qëllim të promovojë interesin e anëtarëve në profesionin e kontabilitetit në përgjithësi dhe të asistojnë së bashku në promovimin e ndërsjellë të dy institucioneve. IPA numëron mbi 35,000 studentë dhe anëtarë në mbarë botën.

ShKÇAK dhe CIPFA (Chartered Institute of Public Finance and Accountancy) nga Anglia nënshkruan marrëveshjen e bashkëpunimit në vitin 2012 me qëllim të zhvillimit të kualifikimeve të përbashkëta dhe me anë të së cilës, anëtarët e Shoqatës do të kenë mundësi të përfitojnë anëtarësi të dyfishtë.

Ky program ka për qëllim specializimin e të gjithë zyrtarëve financiarë të institucioneve publike si dhe gjeneratave të reja të studentëve që dëshirojnë të profilizohen në këtë sektor.



“Kreativiteti, përkushtimi dhe qëndrimi pozitiv ndaj punës dhe profesionit përputhen vetëm me dëshirën e madhe për të pasur sukses, kjo na frymëzon të gjithëve që të japim më të mirën nga vetja. E di që nuk ka qenë një rrugëtim i lehtë, por ka qenë përmbushës. Le të presim më të mirat në vitet e ardhshme. Filluat me pak, por sot dhe në të ardhmen, sigurisht do vazhdoni, te jeni shembull i nivelit të lartë profesional.”

Shaban Muharremi,
Kryetar i Këshillit 2014-2016

Në vitin 2010, SHKÇAK ka arritur që anëtarët e saj që mbajnë titullin e kualifikimit profesional "Specialist i Insolvencës" të anëtarësohen me të drejta të plota në INSOL Evropë.

INSOL Europe është organizatë evropiane e profesionistëve të specializuar në fushën e insolvencës, bankrotimit, riorganizimit dhe rimëkëmbjes së bizneseve. INSOL Europe numëron më se 1250 anëtarë në 50 shtete të ndryshme.



Duke qenë anëtare me të drejta të plota në Federatën Evropiane të Kontabilistëve dhe Auditorëve për NVM (EFAA) gëzon benefitet e Marrëveshjes së bashkëpunimit në mes të EFAA dhe Zyrës për Pronësi Intelektuale të Bashkimit Evropian (EUIPO). Kjo marrëveshje bashkëpunimi iu mundëson anëtarëve të SHKÇAK të informohen dhe të kenë qasje në resurset e Pronësisë Intelektuale. Anëtarët e Shoqatës gjithashtu do të mund të ju ndihmojnë klientëve të tyre të bizneseve të regjistronjë të drejtat e tyre të Pronësisë Intelektuale.


Trendet e reja paraqitja e aseteve digjitale, kriptovalutave dhe teknologjisë "blockchain" është duke transformuar me shpejtësi sistemin monetar global dhe duke dashur të jetë gjithnjë afër zhvillimeve të fundit, SHKÇAK ka nënshkruar memorandum bashkëpunimi me Shoqatën Globale të Aseteve Digjitale dhe Kriptovalutave (Global DCA).

Global DCA është një shoqatë globale vetërregulluese për industrinë e aseteve digjitale dhe kriptovalutave. SHKÇAK dhe Global DCA së bashku do të angazhohen në dialog për çështjet kyçe në temën e aseteve digjitale, financave të decentralizuara dhe temave të tjera të ngjashme si dhe zhvillojnë aktivitete të përbashkëta duke përfshirë konferenca, uebinar, dhe hulumtime.



"Kam pasur kënaqësinë të punoj me SHKÇAK për 15 nga 20 vitet që po festojmë sot! SHKÇAK vazhdon të më mahnitë me inovacionin e saj, ekspertizën teknike dhe kontributin e tyre në rritjen ekonomike të Kosovës. SHKÇAK është një shembull i shkëlqyeshëm i lidershit me pasion, qeverisjes së mirë dhe profesionistëve të përkushtuar – me të vërtetë më të mirët në atë që nxit zhvillimin e sektorit financiar dhe ekonomik. Pres me padurim 20 vitet e ardhshme dhe jam i emocionuar të shoh se si SHKÇAK do të vazhdojë të ndihmojë profesionin e kontabilitetit, popullin e Kosovës dhe botën. Urime SHKÇAK!"

Gabriella Kusz, Director, Global DCA,



COVID19 - SFIDË QË E KARAKTERIZOI FUNDIN E DEKADËS SË DYTË



Pandemia (COVID-19) shumë shpejt nga paraqitja e rastit të parë gjatë vitit 2020 është kthyer në një pandemi mbarëbotërore. Pasojat e saj vazhduan gjatë vitit 2021 të paraqesin sfida të papritura dhe mjaft të rënda për organizatat e të gjitha madhësive dhe sektorëve në të gjithë botën. Kompleksiteti i situatës ka transformuar mënyrën se si funksionon ekonomia dhe se si jetojnë dhe punojnë individët. Efektet më negative janë reflektuar në shëndetin njerëzor duke prekur qindra milionë njerëz dhe duke shkaktuar vdekje të disa milionë njerëzve në gjithë botën.

Pandemia duke përfshirë edhe Kosovën, filloi të mobilizojë institucionet shëndetësore, autoritetet qeveritare dhe të gjitha institucionet tjera publike dhe private në Kosovë për të zbatuar masa parandaluese ndaj COVID-19 të rekomanduara nga Institucioni Botëror i Shëndetësisë.

ShKÇAK, ka qenë në kontakt të vazhdueshëm me partnerët e saj dhe pjesëmarrësit relevantë siç janë odat ekonomike, institucionet qeveritare dhe federatat kombëtare të vendeve të ndryshme në mënyrë që të sigurohej një rrjedhë më e mirë e informacionit dhe të bashkoheshin përpjekjet për zbutjen e pasojave të pandemisë si nga perspektiva shëndetësore, ashtu edhe nga ajo ekonomike.


Në këtë situatë, ShKÇAK vlerësoi situatën, zhvilloi planin dhe ndërmori masat për të vazhduar funksionimin.

Bordi i ShKÇAK me qëllim primar ruajtjen e shëndetit dhe parandalimin e përhapjes së pandemisë Covid 19 aprovoi pezullimin e përkohshëm të të gjitha aktiviteteve të Shoqatës gjatë vitit 2020 në mënyrë fizike, përfshirë sesionet e trajnimeve, sesionet e provimeve dhe sesionet e edukimit të vazhdueshëm profesional.

Kjo situatë e krijuar nga pandemia Covid 19 ka bërë që ShKÇAK të gjejë mundësi të tjera për të vazhduar punën në shërbim të anëtarëve dhe duke e parë si domosdoshmëri për të shpejtuar në transformimin digjital, avancimin e proceseve të brendshme dhe përmbushjen e obligimeve ndaj anëtarëve nëpërmes platformave virtuale, duke organizuar në mënyrë të njëjtë edhe procesin e ligjërimeve.

Gjatë kësaj periudhe, ShKÇAK ka lansuar portalin COVID-19 për të mbajtur të informuar anëtarët dhe opinionin publik me zhvillimet e fundit rreth masave të marra ndaj pandemisë COVID-19 përmes artikujve dhe opinioneve të publikuara nga anëtarët e shoqatës, federatat dhe organizatat ndërkombëtare.

Që nga dita e parë e shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme për shëndetin publik, ShKÇAK ka punuar në përgatitjen e rekomandimeve dhe kërkesave ndaj Qeverisë të Republikës së Kosovës për të mundësuar lehtësime në raportimet e pasqyrave financiare, raportimet tatimore dhe shtyrjen e pagesave ndaj obligimeve tatimore. ShKÇAK përgatiti po ashtu dokumentin "Rekomandimet për veprim të menjëhershëm drejt Rimëkëmbjes Ekonomike", me qëllim të ndihmës ndaj anëtarëve të vet si dhe për të ulur efektin negativ në ekonominë së vendit nga impakti i Covid 19.





SHKÇAK – RRUGA PËRPARA

ShKÇAK me punën dhe angazhimin për të mbrojtur interesin publik do të vazhdoj të ecë përpara, do të jetë lidere në avancimin e profesionit të kontabilitetit, auditimit dhe shërbimeve tjera të specializuara duke ofruar gjithmonë zgjedhjen më të mirë për profesionistët për të ardhmen dhe e gjitha do të arrihet për shkak të komunitetit të mahnitshëm që përfaqëson.

Me besimin dhe mbështetjen e Bordit, Komisioneve, anëtarëve dhe stafit, ShKÇAK do të vazhdojë rrugëtimin në zhvillim të profesionit edhe në dekadën e tretë.

Anëtarët e Këshillit/Bordit të ShKÇAK

2001-2002

Lekë Musa - Kryetar
Bashkim Uka
Bujar Sokoli
Eugen Nuri
Jan Tyl
Lindita Shala
Mustafë Ibrahim

2003-2004

Bashkim Uka - Kryetar
Nazmi Pllana - Nënkyetar
Agron Ferati - Thesarist
Fahri Breznica
Ilir Kasneci
Lindita Shala
Shahe Shala Berisha

2005-2007

Nazmi Pllana - Kryetar
Bekim Berisha - Nënkyetar
Ilir Kasneci - Thesarist
Adrian Alo
Besa Berisha
Fahri Breznica
Naim Avdiu
Sefadin Daci

2002-2003

Bashkim Uka - Kryetar
Lindita Shala - Nënkyetar
Tomorr Zhaveli - Thesarist
Avni Jashari
Bujar Sokoli
Faton Zeqiri
Gezim Pirana

2004-2005

Bashkim Uka - Kryetar
Nazmi Pllana - Nënkyetar
Agron Ferati - Thesarist
Fahri Breznica
Ilir Kasneci
Jan Tyl
Shahe Shala Berisha

2007-2009

Naim Avdiu - Kryetar
Bekim Berisha - Nënkyetar
Shyqiri Bytyqi - Arkatar
Afërdita Çarkaxhiu
Besa (Sahitaj) Berisha
Astrit Musa
Zukë Zuka

2009-2010

Naim Avdiu - Kryetar
Bekim Berisha - Nënkyetar
Shyqiri Bytyqi - Thesarist
Afërdita Çarkaxhiu
Fahri Breznica
Liman Beka
Nazmi Pllana

2012 -2014

Fahri Breznica – Kryetar
Shaban Muharremi – Nënkyetar
Adrian Alo – Thesarist
Avni Jashari
Bekim Berisha
Mentor Hyseni
Visar Peci

2016-2018

Nazmi Pllana – Kryetar
Afërdita (Çarkaxhiu) Gashi – Nënkyetare
Lindita Matoshi – Thesariste
Besa Sahitaj Berisha
Fahri Breznica
Arbresha Tuhina
Burim Zagragja

2020-2022

Shpresa Mustafa – Kryetare
Nazmi Pllana – Nënkyetar
Melita Ymeraga – Thesariste
Burim Cena
Teuta Ukshini
Xhevdet Beqiri
Aurora Dinaj

2010-2012

Nazmi Pllana - Kryetar
Fahri Breznica - Nënkyetar
Shyqiri Bytyqi - Thesarist
Afërdita Çarkaxhiu
Burim Zagragja
Liman Beka
Tomorr Zhaveli

2014 -2016

Shaban Muharremi – Kryetar
Nazmi Pllana – Nënkyetar
Melita Ymeraga – Thesariste
Ariana Salihu Rozhaja
Sakip Imeri
Shyqiri Bytyqi
Ibrahim Gjylderen

2018-2020

Afërdita (Çarkaxhiu) Gashi – Kryetare
Shpresa Mustafa - Nënkyetare
Fahri Breznica - Thesarist
Arbresha Tuhina
Arlind Sadrija
Xhevdet Beqiri
Yll Fondaj

Anëtarët e komisioneve të ShKÇAK

Komisioni Disiplinor

2004 – 2008

Shaban Muharremi
Avni Jashari
Bekim Berisha
Afërdita Çarkaxhiu

2008 – 2010

Shpresa Mustafa
Syzane Kaqaniku
Shaban Muharremi

2010 – 2013

Avni Jashari
Agim Bulliqi
Hysen Ramabaja
Liman Morina
Ymer Mehmeti

2013 -2016

Agim Bulliqi
Hysen Ramabaja
Ymer Mehmeti
Bahri Hyseni
Muhamet Feka

2016-2019

Arlind Sadrija
Aurora Sinanaj Dinaj
Nazmi Sahitaj
Shyqiri Bytyqi
Yll Fondaj

2019-2022

Elvira Ibrahim Hoti
Nekibe Haziri
Kaltrina Kadriu Xhemaj
Alban Lufi
Fitore Neziri

Komisioni për nominime

2010-2013

Adrian Alo
Avni Jashari
Bashkim Uka
Bekim Berisha
Besa Sahitaj Berisha
Naim Avdiu
Nazmi Pllana

2014 -2018

Shaban Muharremi
Fahri Breznica
Nazmi Pllana
Adrian Alo
Tomorr Zhaveli
Burim Zagragja
Afërdita Gashi

2018-2022

Afërdita Gashi
Shpresa Mustafa
Nazmi Pllana
Adrian Alo
Tomorr Zhaveli
Bashkim Uka
Mentor Hyseni

Komisioni për standarde profesionale

2010 – 2016

Adrian Alo
Alban Lufi
Ardiana Bunjaku
Bekim Berisha
Jan Tyl
Lulzim Zeka
Nazmi Pllana

2016 - 2021

Nazmi Pllana
Adrian Alo
Bekim Berisha
Arbër Hoti
Alban Lufi
Teuta Ukshini
Lulzim Berisha
Xhevdet Beqiri

Komisioni për sigurim të cilësisë

2010 – 2016

Ardiana Bunjaku
Fahri Breznica
Lekë Musa
Naim Avdiu
Paul Hurks

2016 - 2021

Ardiana Bunjaku
Fahri Breznica
Lekë Musa
Naim Avdiu
Paul Hurks

Komisioni për tatime

2010-2016

Burim Ahmeti
Sakip Imeri
Shaban Muharremi
Shyqiri Bytyqi

2016 - 2021

Tomorr Zhaveli
Fahri Breznica
Burim Zagragja
Arbër Hoti
Sakip Imeri
Xhemail Syla

Komisioni për edukim profesional

2010-2016

Arben Avdiu
Arbër Hoti
But Dedaj
Edona Perjuci
Liam Coughlan
Naim Avdiu
Visar Peci

2016 - 2021

Naim Avdiu
Edona Perjuci
Lulzim Zeka
Visar Peci
Riza Spanca

Komisioni për Insolvencë

2010-2016

Beqir Krasniqi
Burim Ahmeti
Edona Perjuci
Liman Beka
Suzane Dërvari

Komisioni për Auditor Ligjor

2021-2024

Ymer Shatri
Lekë Musa
Besa Sahitaj Berisha

Komisioni për Kontabilist të Çertifikuar

2021-2024

Arbresha Tuhina
Fitore Mekaj
Blerim Haliti

Komisioni për Edukim dhe Standarde Profesionale

2021-2024

Lulzim Zeka
Drita Kadriu Berisha
Nazmi Pllana

Komisioni për Tatime

2021-2024

Fahri Breznica
Shyqiri Bytyqi
Arlind Sadrija

Komisioni për Menaxhim të Cilësisë në Pajtueshmëri me Standarde

2021-2024

Mentor Hyseni
Shpresa Musatafa
Bahri Hyseni

Stafi i ShKÇAK

Stafi - Aktual

Arbër Hoti
Ardiana Bunjaku
Avni Iseni
Blerim Pushkolli
Burbuqe Godanci
Burim Ahmeti

Dafina Osmani
Edona Perjuci
Enkela Gjata
Fatos Shema
Lendita Shahini-Ustaibo
Liridona Sopu
Naim Avdiu
Rina Sejdiu
Gëzime Hajdini

Stafi - Ndër vite:

Afërdita Pustina
Alma Xhemalaj
Arben Dermaku
Arben Nushi
Arian Zeka
Art Navakazi
Artor Nuhui
Bashkim Hajrizi
Besa Halili
Besarta Ajeti
Besim Shala
Blerta Haxhidauti
Dafina Prekazi
Dardan Makolli
Drin Kryeziu
Driton Pustina
Elvira Ibrahim-Hoti

Ermal Kozgori
Fahrije Bejtullahu
Faruk Prebeza
Fatma Zymberi Fejza
Fatos Sylaj
Fiona Beqiri
Fitore Bekteshi
Florin Gjota
Flutra Pushka
Gonxhe Beqiri
Granit Vitija
Kreshnik Vokshi
Kushtrim Krasniqi
Labinot Halilaj
Lekë Musa
Lulzim Berisha
Lulzim Krasniqi
Lulzim Zeka
Mentor Berisha

Mevlyde Mjekiqi
Myrvete Bajrami
Naser Arllati
Natyra Muhadri
Nazlije Mjekiqi
Nertila Latifi
Nora Isufi
Qëndresa Çeku
Qëndresa Gojani
Rakella Krasniqi
Rinor Kongjeli
Sara Habipaj-Polloshka
Teuta Karameta
Teuta Xhakija
Theranda Beqiri
Torvioll Ukëhaxhaj
Visar Krusha
Vlora Çoçaj

Ligjëruesit dhe asistentët e ShKÇAK

Adrian Alo
Afërdita Pustina
Agim Ferati
Aida Podrimaj
Alban Lufi
Alma Xhemalaj
Anila Statovci-Demaj
Arben Canolli
Arben Dermaku
Arber Hoti
Arberor Prekazi
Arian Zeka

Artan Nikollprenkaj
Astrit Musa
Astrit Shehu
Avni Berisha
Bejta Kapiti
Bekim Berisha
Dardane Peja
Driton Aliu
Driton Balaj
Driton Hapçiu
Durim Krasniqi
Edmond Beqiri
Edona Perjuci
Egzona Morina
Elhami Maloku
Elvira Ibrahim-Hoti

Fahri Breznica
Faruk Prebeza
Fitim Haliti
Flutra Pushka
Kadrush Qollaku
Kastriot Dushi
Krenar Mustafa
Lekë Musa
Lekë Zogaj
Lirim Kryeziu
Lirinda Alishani
Lulzim Berisha
Lulzim Ismajli
Lulzim Krasniqi
Lulzim Zeka
Lyra Osmani Ahmeti

Mentor Arifaj
Mentor Berisha
Mentor Gashi
Mentor Hyseni
Milaim Aliu
Mimoza Godanci
Mirjeta Hysa
Naim Avdiu
Nazmi Pllana
Njomza Zejnullahu
Pëllumb Halilaj
Resul Kasumi
Riza Spanca
Ruzhdi Zenelaj
Sakip Imeri
Sefadin Daci
Shaban Muharremi
Shahe Shala Berisha
Shkelzen Morina

Shkendije Himaj
Shyqiri Bytyqi
Skender Breznica
Theranda Beqiri
Ujkan Bajra
Valbona Raifi
Vërshim Hatipi
Violeta Haxhillazi
Visar Jasiqi
Visar Peci
Yll Fondaj
Zijad Krasniqi
Zilif Lufi

Nëse në këtë monografi rastësisht mungon emri i ndonjërit nga bashkëpunëtorët, kërkohet ndjesë për lëshim të paqëllimshëm.

